



Nr. _____ Prot. _____

Tiranë, më 28/06/2024

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT ALTIN MERIZAJ

Nr. 32, datë 14.06.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Edona Dushaj	Kryesuese
Enton Radovani	Relator
Kleada Mersinllari	Anëtare

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtare e Sekretariatit Teknik, znj. Erlisa Kalaja, në datën 14.06.2024 ora 10:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket

SUBJEKTI I VLERËSIMIT:

Altin Bashkim Merizaj, me funksion aktual Drejtor i Drejtorisë Vendore Për Kufirin dhe Migracionin, Durrës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi relatimin e **relatorit të çështjes z. Enton Radovani**; dëgjoi subjektin e vlerësimit, z. **Altin Merizaj**, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 14.06.2024, kërkoi konfirmimin e tij në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Durrës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në tre kriteret e vlerësimit të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit 12/2018, i ndryshuar,

V Ë R E N

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi Altin Merizaj është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit më datë 05.04.2023 si “Drejtor i Drejtorisë Vendore Për Kufirin dhe Migracionin, Shkodër” dhe me funksion aktual Drejtor i Drejtorisë Vendore Për Kufirin dhe Migracionin, Durrës.
3. Subjekti i vlerësimit, z. **Altin Merizaj** iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar me datë 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7 datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin nr. 29/1, datë 18.04.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: z. Enton Radovani, **Relator**, znj. Edona Dushaj, **Kryesuese**, dhe znj. Kleada Mersinllari, **Anëtare**.
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin nr. 29/2, datë 18.04.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Altin Merizaj.
6. Relatori i çështjes, z. **Enton Radovani**, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar nr.28/6 prot., datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.

7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datën 24.04.2023, e cila është protokolluar me nr. 29/3, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
10. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
 - ✚ vlerësimin e pasurisë;
 - ✚ kontrollin e figurës;
 - ✚ vlerësimin e aftësive profesionale.
11. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligji 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
 - b. Ligji nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”
 - c. Ligji nr.40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”
 - d. Ligji nr.49/2012 “Për gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”
 - e. Ligji nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”
 - f. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7 datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”
 - g. Rregulloren nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”
 - h. duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit në Ministrinë e Brendshme që janë:
 - ✚ *Deklarata e Pasurisë,*
 - ✚ *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
 - ✚ *Formulari i Vlerësimit Profesional*
 - ✚ *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,*
 - i. Raportet përmbledhëse të ILDKPKI-së, Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në AMP, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
 - j. Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.
 - k. Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.
 - l. ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

12. Trupa e vlerësimit, me datë 25.05.2024, pasi dëgjoji relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Altin Merizaj, me Vendimin nr. 5, datë 25.05.2024, vendosi;
- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Altin Merizaj,
 - b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - ✚ *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 - ✚ *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*
 - c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.
13. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
14. Në datën (28.05.2024), trupa e vlerësimit, njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 30.05.2024, ora 10:30, në ambiente të Ministrisë së Brendshme, në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit 12/2018, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Altin Merizaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të mos përfaqësohej me mbrojtës ligjor në këtë seancë. Në fund të seancës dëgjimore të datës 30.05.2024, subjekti i vlerësimit z. Altin Merizaj kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Me subjektin e vlerësimit është komunikuar me anë të postës elektronike, duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave. Subjekti i vlerësimit z. Altin Merizaj, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë hetimit.

IV. VLERËSIMI I PASURISË

15. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
16. Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit **z. Altin Merizaj** ka dorëzuar deklaratën e pasurisë brenda afateve ligjore. Formulari i Pasurisë ka nr. 1 index, viti 2023.
17. Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
18. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
19. Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklarimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34 , shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.
20. **Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:**
 - ✚ deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
 - ✚ raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
 - ✚ provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
 - ✚ dokumentacionin e paraqitur në deklarimet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike;
21. **Hetimi administrativ konsistoi në:**
 - ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
 - ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit e të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
 - ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
 - ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit;

A. DEKLARIMI I PASURIVE

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja;

22. ILDKPKI-ja, në përputhje me Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport¹, të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Altin Merizaj, ku është konstatuar se:

- ✓ **deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- ✓ **nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- ✓ **nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- ✓ **nuk është kryer deklarim i rremë;**
- ✓ **subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

B. PROCEDURA E VLERËSIMIT/HETIMIT E KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT

23. Bazuar në nenin 34 të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e vlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, (b) raportin/vlerësimin e kryer nga ILDKPKI; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private sipas nenit 34 të ligjit 12/2018; (ç) deklarinimet e subjektit të vlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit; (dh) deklarinimet në seancë dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

24. Trupa e Vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, hetim i cili konsistoi në: (I) verifikimin e vërtetësisë së deklarinimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, (II) verifikimin e burimeve të krijimit të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllimin evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (III) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (IV) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarinimeve të rreme apo ndonjë konflikti të interesit.

¹ Raporti nr. 23/53, datë 06.10.2023, i ILDKPKI-së.

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si vijon:

Pasuria nr. 1

- ▣ Apartament banimi me sip. 90.7 m², me adresë rruga "****", pallati nr. ****, shk. *, k. *, ap.**, Tiranë. Blerë më datë 30.12.2011, me çmim 8.163.000 lekë.
Pjesa takuese: 50%.

Burimi i krijimit: Nga shitja e një apartamenti banimi me sip. 54.29 m², në adresën rruga "****", pallati *, shk. *, k. *, ap. **, shitur nga prindërit e tij, në datë 04.11.2011, sipas kontratës noteriale nr. **** rep, nr. **/* kol, shënuar vlerë shitje 3.862.695 lekë, por është shitur 6.600.000 lekë. Kjo banesë është blerë në fund të vitit 2003, kur ka filluar punë si punonjës policie nga ai dhe prindërit e tij, me kursimet familjare të prindërve të tij dhe një kredie të marrë në ish Pro Credins Bank në emrin e tij, por apartamenti është regjistruar në emër të prindërve. Nuk ka mundur të sigurojë dokumentacionin (kontratë noteriale) për blerjen e këtij apartamenti dhe për kredinë pranë Pro Credit Bank.

Kursimet familjare të mia, bashkëshortes dhe prindërve të cilët kanë qenë pjesë e certifikatës familjare në momentin e blerjes së këtij apartamenti.

Kredi në Raiffeisen Bank, në shumën rreth 564.000 lekë e cila është shlyer për tre vjet. Shuma 8.163.000 lekë, pjesa takuese 50 %, sipas certifikatës së pronësisë, por faktikisht për blerjen kanë kontribuar dhe dy prindërit, në momentin e blerjes kanë qenë dhe pjesëtarë të familjes sipas certifikatës familjare.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Kontratë shit-blerje pasuri e paluajtshme nr. **** rep, nr. **** kol, datë 30.12.2011**, me palë shitëse N.E, A.S, dhe F. K. dhe palë blerëse Altin dhe L. Merizaj, me objekt “shitjen e një apartamenti me sip. 90.7 m², me numër pasurie ****, vol. **, fil. ****, zk. ****, e ndodhur në rrugën "*****", Tiranë, në vlerën 8.163.000 lekë, vlerë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale para përpilimit të kësaj kontrate”.
- **Certifikate për vërtetim pronësie datë 18.01.2012**, për pasurinë e llojit apartament, me sip. 90.7 m², me numër pasurie ****, vol. *, fq. ****, zk. ****, e ndodhur në rrugën "****", Tiranë, në emër të Altin dhe L. Merizaj.
- **Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme nr. **** rep, nr. **** kol, datë 04.11.2011**, me palë shitëse B. dhe Xh.M. dhe palë blerëse M.H., përfaqësuar me prokurë të posaçme nga H. C., me objekt “shitjen e një a apartamenti me sip. 54.29 m², e ndodhur në rrugën "****", Tiranë, në vlerën 3.862.695 lekë, të cilat blerësi do ti paguajë në favor të shitësve”.
- **Vërtetim nga Raiffeisen Bank, datë 07.03.2023**, ku konfirmohet kredi e disbursuar më datë 23.11.2011 ndaj Altin Merizaj, në vlerë 564.000 lekë, cila rezulton e shlyer në vitin 2014.

25. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **ASHK Tiranë – D.V. Tirana veri, D.V. Tirana Jug, D.V. Tirana Rurale 1, D.V. Tirana Rurale 2** me shkresat nr. *** prot., cit. 26.6.2023, cit. 26.06.2023, datë 23.06.2023 dhe cit. 07.07.2023, nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të subjektit Altin Merizaj.
- **ASHK online** nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të subjektit.
- **Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023**, ka bashkëlidhur CD të llogarive të Altin Merizaj, ku konfirmon kredi në lekë, disbursuar në datën 23.11.2011, në vlerën 564.000 lekë. Kjo vlerë rezulton e transferuar në datën 01.12.2011, në llogari të L. Merizaj, e cila ka tërhequr vlerën 500.000 lekë. Kredia rezulton e mbyllur në vitin 2014.
- **Pro Credit Bank me shkresën nr. *** , prot, datë 04.05.2023**, konfirmon në emër të Altin Merizaj, kredi në euro, disbursuar në datë 29.04.2004, në vlerën 8.820 euro, mbyllur në vitin 2011.

26. Në deklaratat e interesave privatë të ILDKPI-së "Periodike/Vjetore 2011", "Pas largimit nga funksioni 2012", "Para fillimit të detyrës 2013 " dhe "Pas largimit nga funksioni 2013", subjekti ka deklaruar huanë e marrë nga shtetasi Y. Ç., në datë 27.12.2011, në vlerën 2.000.000 lekë, përdorur për blerjen e apartamentit në datë 30.12.2011, në rrugën "****", Tiranë, me afat shlyerje deri në datën 23.12.2014, pa interes. Nuk kanë nënshkruar kontratë, por kanë përpiluar një deklaratë dore.

26.1. Në ILDKPI është administruar deklaratë e thjeshtë huaje, me shkrim dore, datë 27.12.2011, me palë deklarues Altin Merizaj, i cili deklaroi se ka marrë një hua nga shtetasi Y. Ç., në vlerën 2.000.000 lekë, shumë e cila do të shlyhet brenda një afati prej 3 vitesh, pa asnjë interes. Subjekti deklaroi se shuma e marrë hua do të përdoret prej tij, për të blerë një apartament në rrugën "****", Tiranë. Kjo deklaratë është nënshkruar nga huamarrësi dhe huadhënësi.

26.2 Nga QKB Online, është administruar ekstrakt historik i subjektit person fizik F. Ç., me Nipt ***, me aktivitet bar-kafe, themeluar në vitin 2006, me status pezulluar nga viti 2015. **Në deklaratat e interesave privatë të ILDKPI-së, "Periodike/Vjetore 2011 "**, subjekti ka deklaruar se *"...në datën 04.11.2011 ka shitur shtëpinë që kanë patur më parë në pronësi të familjes, konkretisht apartamentin në adresën Tiranë, rruga "****" pall. *, Shk *, ap. *, me një sipërfaqe totale rreth 90 m², por me hipotekë 54.29 m², dhe pjesa tjetër ka qenë shtesë në procedurë legalizimi, e cila është shitur 6.600.000 lekë, por në kontratën noteriale është shënuar 3.862.695 lekë, sipas vlerësimit të bërë nga ZRPP"*.

27. Në proces-verbalin e datës 23.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, në lidhje me burimin e pasurisë së deklaruar, subjekti sqaroi se *"...kontributi konkret, në vlerë monetare nga prindërit e tij, për blerjen e kësaj pasurie ka qenë rreth 6.000.000 lekë, të cilat prindërit i kanë siguruar nga shitja e një apartamenti të*

ndodhur në rrugën "***", në vlerën 6.600.000 lekë, por që në momentin e shitjes janë marrë vetëm 6.000.000 lekë, dhe pjesa tjetër janë nga një kredi e marrë nga subjekti tek Raiffeisen Bank, kursime të familjes dhe një hua të marrë nga ana e tij. Në momentin që është blerë kjo pronë kanë jetuar bashkë me prindërit, dhe si një familje, të ardhurat mbledheshin bashkë dhe kursimet nuk i kanë pasur të ndara. Burimi i apartamentit të shitur nga prindërit, me kontratën e datës 04.11.2011, ka qenë një pjesë nga Shitja e një shtëpie private në Fshatin Aranitas, Mallakastër, ku kanë banuar me familjen më parë, trualli dhe një sipërfaqe toke shitur prej tyre në vitin 2002, kursime të prindërve në vite, si dhe kredia e marrë nga ana e tij në Pro kredit Bank, në vlerën rreth 9.000 euro. Faktin që apartamenti është shitur nga prindërit me vlerë 6.600.000 lekë dhe në aktin noterial është deklaruar 3.862.695 lekë, nuk mund ta vërtetoj me dokumente zyrtare, pasi personi që e ka blerë nuk ndodhet në Shqipëri. Edhe në momentin kur janë bërë dokumentet për shitjen e kësaj banese, ky shtetas pasi ka ardhur, e ka parë banesën dhe ka rënë dakord për çmimin, është larguar për në Greqi, duke i lënë prokurë vjehrrit të tij shtetasit H. C., i cili ka nënshkruar aktin noterial të shitblerjes së këtij apartamenti, për llogari të blerësit M. H...”

Subjekti sqaron gjithashtu se “shtetasi H. C., i cili është vjehri i blerësit M. H. ka dhënë deklaratë se dhëndri i tij prej vitesh vazhdon të jetojë jashtë shtetit dhe të gjitha veprimet për blerjen e apartamentit janë bërë me prokurë nga ai vetë dhe se kjo banesë është blerë me çmim 6.600.000 lekë ...një rrethanë që mund të ndihmojë në krijimin e bindjes se deklarimi i tij për vlerën e shitjes është i vërtetë, është se në momentin e përpilimit të aktit të shitjes ka marrë vetëm vlerën 6.000.000 lekë, pasi blerësi nuk i kishte të gjitha dhe vlerën 600.000 lekë i ka shlyer më pas, veprim për të cilin ka mundur të gjejë dhe një deklaratë noteriale të së njëjtës datë, me aktin notarial të shitjes, tek e njëjta notere, nënshkruar me prokurë nga H. C., për llogari të blerësit M. H. dhe babai B. M., ku pasqyrohet vlera e ngelur pa shlyer në këtë moment prej 600.000 lekë. Vlera e papaguar prej 600.000 lekë, në momentin e shitjes sipas deklaratës noteriale, nuk është rastësi por lidhet me çmimin total të shitjes prej 6.600.000 lekë. Vlera e shitjes prej 3.862.695 lekë e shkruar në aktin notarial është vendosur sipas çmimit të referencës nga noteri me dakordësinë e babait dhe blerësit. Kontributi i tij në vlerë monetare për këtë shtëpi ka qenë vlera e kredisë në Pro Credit, rreth 9.000 euro, të cilën e ka shlyer për një periudhë rreth 8 vjetësh...”

28. Analiza e provave të paraqitura:

- **Lidhur me sqarimin e faktit se kredia e marrë tek Pro Kredit Bank**, për të blerë këtë apartament, ku rezulton se është marrë pas nënshkrimit të aktit të shit-blerjes shpjegon se nuk ka pasur të ruajtur një kopje të aktit notarial për blerjen e kësaj shtëpie nga babai i tij. Në deklarinimin e mëparshëm ka shpjeguar se është blerë në fund të vitit 2003 me sa mbante mend ai dhe familjarët, por ka mundur të sigurojë nga pala shitëse një kopje të aktit të shitblerjes së kësaj prone, i cili është i datës 13.03.2004, ndërsa kredia ka dalë disa ditë më pas. Në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes nga prindërit, nuk kanë shlyer të gjithë vlerën e çmimit të shitjes, por me mirëbesim shitësi S. H. ka pritur pak kohë deri sa ka dalë kredia dhe atëherë kemi bërë shlyerjen totale të çmimit të rënë dakord. Për këtë fakt ka marrë dhe një deklaratë nga shitësi S. H., i cili deklaroi se ka pritur disa ditë për shlyerjen e një pjese të vlerës së shitjes së shtëpisë deri në momentin që ka dalë kredia.

- **Lidhur me marrjen e një huaje nga shtetasi Y. Ç.**, në vitin 2011 pak ditë para blerjes së apartamentit ku banon, shpjegon se e ka deklaruar këtë hua në deklaratat e mëparshme të bëra nga ana e tij, por në deklarimin e fundit e ka harruar për faktin se ka kaluar dhe një kohë e gjatë. Këtë hua nga shtetasi Y. Ç. e ka marrë pasi nuk ka plotësuar dot të gjithë vlerën e çmimit të blerjes së apartamentit, por me sa mban mend mund të kenë ngelur një pjesë e vogël e tyre pa u përdorur për blerjen dhe janë përdorur për nevoja familjare. Kjo hua në deklaratë është përcaktuar për tu shlyer për tre vjet, por realisht me dakordësinë e huadhënësit është shlyer totalisht për një periudhë prej 5 - 6 vjetësh, datën e saktë nuk e mban mend kur e ka përfunduar. Burimi i shlyerjes së kësaj huaje është nga të ardhurat e familjes së tij dhe të bashkëshortes nga paga si punonjës policie.
- **Lidhur me deklarimin periodik vjetor**, të bërë nga ana e subjektit në vitin 2011, ku ka deklaruar se apartamenti në rrugën “****” ka një sipërfaqe prej 90 m², ku 54,29 m², me certifikate pronësie dhe pjesa tjetër në procedurë legalizimi, ka për të shpjeguar se ky apartament në momentin e blerjes nga familja e tij ka pasur dhe një shtesë të përfunduar. Nga ana e tyre nuk është bërë asnjë lloj investimi për këtë shtesë, pasi ishte e përfunduar me përjashtim të ndonjë mirëmbajtje (pasqyruar dhe në deklaratën e shtetasit S. H.). Kjo shtesë konsistonte në një ambient sallon ndenjeje dhe para saj ishte një hapësirë tjetër e rrethuar me mur, hapësirë e cila është përdorur nga babai i tij për punishte alumini. Shtesa e banueshme me përafërsi mendon se mund të shkonte rreth 40 m² dhe prandaj është deklaruar në total, nga ana e tij, shtëpia 90 m². Në lidhje me deklarimin për procedurën e legalizimit, shpjegon se në momentin e blerjes së këtij apartamenti, nga shitësit i është thënë se shtesa është futur për legalizim, por nuk kanë mundur të gjejnë dokumentacion. Gjithashtu subjekti sqaroi se shpenzimet për mobilimin e apartamentit janë bërë gradualisht ndër vite dhe aktualisht ato janë të vjetra, mobilie dhe pajisje elektroshtëpiake, me vlerë rreth 270.000 lekë. Pajisjet e mësipërme, si e ka shpjeguar janë të vjetra të blera para disa vitesh dhe nuk disponon dhe as nuk mund të gjejë faturë për blerjen e tyre.

29. Në proces-verbalin e datës 23.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë e thjeshtë nga B. M., viti 2023, i cili deklaroi se në vitin 2002 kanë shitur një shtëpi private, truallin dhe një sipërfaqe toke në fshatin Aranitas, Mallakastër, tek G. B. dhe bashkëshortja e tij P. B., në vlerën 2.000.000 lekë, të cilat i janë dhënë në dorë nga blerësi dhe janë administruar nga B. M., si kryefamiljar. Në vitin 2004 kanë blerë një apartament në rrugën “****”, Tiranë, ku kanë jetuar bashkë me djalin dhe bashkëshorten e tij për disa vite. Ky apartament është blerë me akt noterial nga B. dhe Xh. M, për blerjen e të cilit janë përdorur një pjesë e shumës, të kursyera nga shitja e shtëpisë private në Mallakastër dhe meqë nuk kanë plotësuar dot vlerën, Altin Merizaj ka marrë një kredi rreth 9.000 euro. Shitësi i ka pritur disa ditë pasi ka dalë kredia për shlyerjen e vlerës së shitjes. Ky apartament në momentin e blerjes ka patur dhe një shtesë të përfunduar dhe nga ana e tyre nuk është bërë asnjë lloj investimi. Kjo hapësirë është përdorur nga babi B. M., nga viti 2004 deri 2011 për punishte alumini, por aktiviteti ka qenë i pa regjistruar. Në lidhje me procedurat e legalizimit sqaron se nga ana e tij janë mbyllur disa dokumente për legalizim, por pasi e kanë shitur shtëpinë nuk kanë më informacion.

- **Kontratë shit-blerje nr.*** rep, nr. *** kol, datë 13.03.2004**, me palë shitëse L. R. dhe S. H., dhe palë blerëse B. Merizaj, të pasurinë me nr. ***, Zk ***, vol. *, fq. *, e llojit apartament, i ndodhur në rrugën ***, Tiranë, me sipërfaqe 54.29 m², në vlerën 2.000.000 lekë, shumë e paguar përpara përpilimit të kontratës.
- **Deklaratë e thjeshtë nga S. H., datë 16.06.2023**, i cili deklaron se ai dhe bashkëshortja L. R., i kanë shitur një apartament shtetasit B. Merizaj. Sipas aktit noterial, pasuria e shitur është me nr. ***, zk. ***, vol. *, fq. **, e llojit apartament, i ndodhur në rrugën "****", Tiranë, me sipërfaqe 54.29 m². Vlera e shitjes e shënuar në aktin noterial, prej 2.000.000 lekë, është dhënë; një pjesë në dorë nga blerësi, ndërsa një pjesë tjetër prej 800.000 lekë, në mirëbesim duke e pritur disa ditë apo muaj, nuk e mban mend mirë, deri sa të dilte kredia bankare, shumë të cilën më pas ja ka dhënë në dorë dhe nuk ka asnjë pretendim. Gjithashtu shpjegon se përveç hapësirës së parashikuar në certifikatë, apartamenti ka pasur edhe një shtesë bashkëngjitur, që përdorej si sallon dhe një hapësirë tjetër si tip oborri. Këto shtesa janë bërë ndër vite, shumë më parë se të shiste këtë pronë dhe nuk mban mend, nëse ka aplikuar ose jo për legalizim.
- **Printim nga sitemit Tims** për shtetasin M. F. H., për hyrjet dhe daljet, për vitin 2022. Lëvizja e fundit rezulton (dalje) nga territori shqiptar, në datën 03.09.2022, nga porti i Durrësit.
- **Deklaratë e thjeshtë, datë 17.06.2023, nga shtetasi H. C.**, i cili deklaron se në vitin 2011, dhëndri i tij shtetasi M. H. ka rënë dakord me palën shitëse për të blerë një apartament në Tiranë, rruga "****", dhe duke qenë se ai jetonte familjarisht në Greqi i ka lënë prokurë, për të bërë dokumentet për blerjen e kësaj prone. Në datën 04.11.2011 është bërë akti noterial i shit-blerjes së kësaj prone dhe në bazë të prokurës ka firmosur për llogari të blerësit. Mban mend që kjo shtëpi është blerë në vlerën 6.600.000 lekë, të cilat nuk kanë kaluar nëpërmjet bankës, por i janë dhënë në dorë shitësit B. Merizaj, madje për një pjesë të tyre rreth 600.000 lekë, ka pritur pak kohë dhe ja kanë shlyer më pas. Përveç hapësirës së përshkruar në certifikatën e pronësisë, apartamenti ka pasur të ndërtuar dhe një shtesë në anën lindore të tij.
- **Deklaratë noteriale nr. *** rep, datë 4.11.2011, me palë deklaruese B. Merizaj dhe M. H.**, përfaqësuar me prokurë nga H. C. Shtetasi H. C., në cilësinë e përfaqësuesit të palës blerëse, deklaron se në përputhje me detyrimin monetar që rrjedh nga kontrata e shitjes nr. *** rep, nr. *** kol, datë 04.11.2011, me vlerë 3.862.695 lekë, me nënshkrimin e kontratës, nuk është shlyer vlera e plotë e shitjes, pasi ka mbetur edhe shuma prej 600.000 lekë. Këtë shumë do ta paguajë në favor të B. Merizaj deri në datë 31.05.2011. Shtetasi B. Merizaj deklaron se është dakord për sa më sipër.
- **Deklaratë e thjeshtë, datë 16.06.2023, nga Y. Ç. dhe F. Ç.** Shtetasi Y. Ç. deklaron, se në lidhje me një deklaratë huaje të datës 27.12.2011, për një shumë prej 2.000.000 lekë të marrë hua nga Altin Merizaj, për të cilën ka qenë në dijeni dhe F. Ç. Shpjegojnë se kjo shumë lekësh është shlyer nga Altin Merizaj, në disa pjesë, për një periudhë prej rreth 5 - 6 vjetësh. Në lidhje me burimin shpjegojnë se kanë patur një aktivitet tregtar të përbashkët, regjistruar në emër të F. Ç., por që e kanë patur bashkë me vëllain Y. Ç., me Nipt ***, regjistruar që nga viti 2006 e në vazhdim, me fushë veprimtarie Bar Kafe, etj. Që nga viti

2015 e në vazhdim ky aktivitet është i pezulluar dhe nuk disponojnë dokumentacion dhe nuk dinë se sa fitim kanë deklaruar në ato vite në organet tatimore. Deklarojnë se burimi i vlerës monetare të dhëne hua nga shtetasi Y. Ç. te Altin Merizaj është tërheqja në muajin Gusht të 2011 e një shume prej 40.000 euro, nga shtetasi F. Ç. pranë BKT, të cilat janë hedhur më datë 16.08.2011 në llogari të F. Ç. nga një shtetas tjetër, për shlyerje detyrimi, veprime të cilat vë në dispozicion dokumentacionin lëshuar nga BKT.

- **Nxjerrje llogarie nga BKT, datë 15.06.2023**, për llogari në euro në emër të F. C., ku konstatohet se në datën 16.08.2011 kreditohet vlera 40.000 euro me përshkrimin "T. P., kalon në favor të F. C., për likuidim detyrimi vlerë e cila tërhiqet nga F. C., në datën 17.08.2011.

30. Në proces-verbalin e datës 20.07.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga

trupa e vlerësimit, subjekti ka sqaruar se *"...pas shitjes së apartamentit në rrugën ****" Tiranë, babai dhe nëna kanë banuar disa vite me subjektin në apartamentin e blerë në rrugën ****, Tiranë, deri në Vitin 2018, dhe më pas, nga ky vit e në vazhdim, shumicën e kohës kanë jetuar tek motra e tij në Fier, pasi ajo ka dy fëmijë, njëri prej të cilëve është i sëmurë, dhe ka nevojë për ndihmën e tyre. Sqaroi se prindërit e tij, gjatë periudhës pas shitjes së apartamentit në rrugën **** Tiranë, nuk kanë blerë ndonjë pasuri tjetër. Në lidhje me deklaratën noteriale nr. *** rep, datë 04.11.2011, ku citohet se "...këtë shumë do ta paguajë në favor të B. Merizaj deri në datë 31.5.2011", sqaron se është bërë lapsus nga ana e noterit, pasi duhej të ishte përcaktuar data 31.05.2012 dhe jo ajo e vendosur nga noteri në deklaratë.*

- **Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** prot, datë 14.09.2023**, me palë deklaruese B. dhe Xh. Merizaj, të cilët deklarojnë se në vitin 2011 kanë shitur apartamentin e blerë në vitin 2004 në rrugën ****, Tiranë, tek shtetasi M. H., i cili pasi e ka parë dhe ka rënë dakord për apartamentin është larguar duke qenë se jetonte jashtë vendit dhe veprimet janë bërë nga vjehri i tij H. C. Kjo shtëpi me dakordësinë e dy palëve është shitur në vlerën 6.600.000 lekë, por në aktin noterial të shitjes është vendosur çmimi bazë i referencës prej 3.862.695 lekë. Për vlerën 600.000 lekë, blerësi nuk ka patur mundësi ta shlyente në momentin e shitjes dhe për këtë kanë bërë një akt noterial dhe vlera është shlyer më pas. Vlera prej 6.000.000 lekë e marrë nga shitja e këtij apartamenti nga ana e tyre, i është dhënë djalit Altin Merizaj, për të blerë një apartament në rrugën ****, Tiranë, ku jeton aktualisht. Kjo vlerë i 'u dha djalit, pasi kishte kontribuar në blerjen e apartamenti që u shit, duke marrë dhe kredi, dhe për këtë vlerë deklarojnë nuk kanë asnjë pretendim.

31. Konkluzion:

- ✓ Apartamenti me sip. 90.7 m², me adresë rruga ****, Tiranë, në zotërim 100 % të subjektit dhe bashkëshortes, me vlerë 8.163.000 lekë është përfituar me kontratë blerje të vitit 2011, me burim pjesërisht kursimet familjare, të ardhura nga shitja e një apartamenti të mëparshëm në emër të prindërve, huamarrje dhe kredi bankare (të shlyera).
- ✓ Burimi i blerjes së apartamentit në rrugën ****, të shitur nga prindërit në vitin 2011 është nga shitja e një shtëpie, truallit dhe një pjesë të tokës bujqësore, të ndodhura në fshatin

Aranitas, Mallakastër (*trajtohet më poshtë*), si dhe një kredi bankare marrë nga subjekti në Pro Credit Bank.

- ✓ Huaja në vlerën 2.000.000 lekë, marrë në vitin 2011 nga shtetasit Y. dhe F. Ç., e pa specifikuar si burim në deklaratën e pasurisë për vlerësimin kalimtar (është deklaruar nga subjekti në DPV 2011, e në vazhdim), me gjykimin që ajo është e shlyer nga të ardhurat familjare. Burimi i huadhënësve rezulton nga një tërheqje bankare pranë BKT, në vlerën 40.000 euro, rreth 4 muaj para dhënies së huasë (vërtetuar me dokument). Shlyerja e kësaj huaje është kryer për një periudhë 5 - 6 vjeçare.
- ✓ Çmimi i apartamentit të shitur në vitin 2011 në rrugën "****", Tiranë, në emër të prindërve, sipas kontratës rezulton në vlerën 3.862.695 lekë (*çmimi i referencës*), ndërsa subjekti pretendon se apartamenti realisht është shitur në shumën 6.600.000 lekë. Për diferencën ka paraqitur si dokumente justifikues, deklarata noteriale të palëve.

32. Qëndrimi i trupës së vlerësimit:

Trupa e vlerësimit nuk merr për bazë justifikimet dhe pretendimet e subjektit se apartamenti në rrugën "**", ka çmim të ndryshëm nga ai i deklaruar sipas kontratës. Megjithëse këto praktika janë të njohura rëndom, ajo nuk mund të legalizojë dhe të inkurajojë mos deklarimin real e të ardhurave dhe mos pagimin e detyrimeve tatimore, sipas legjislacionit në Republikën e Shqipërisë.**

Pasuria nr. 2

- ✚ 9.480 m² tokë bujqësore, në ish komunën Aranitas, fshati Aranitas, Bashkia Mallakastër, të marrë me ligjin nr. 7501, në pronësi të gjithë familjes, pasi është ndarë sipas numrit të pjesëtarëve dhe në atë kohë familja përbëhej nga katër anëtarë (babai, nëna, motra dhe unë). Rreth 4.500 m² të kësaj sip. toke është mbjellë me ullinj, gjithsej janë mbjellë 145 rrënjë ullinj.

Burimi i krijimit: toka përfituar me ligjin nr. 7501. Ullinjtë mbjellë me kursimet e prindërve dhe janë pronë e përbashkët e gjithë familjes. Mbjellja e ullinjve ka kushtuar rreth 100.000 lekë. Zotëron 25 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **AMTP, nr. 1752**, ku konfirmon se shtetasi B. Merizaj, nga fshati Aranitas, ka përfituar tokë bujqësore gjithsej 9.480 m², nga të cilat arë 7.900 m², pemëtore 900 m², ullishte 680 m² dhe truall 250 m².

Hetimi i kryer nga trupa e vler në Ilogarinë ësimit:

33. ASHK. Zyra Vendore Mallakastër, me shkresën nr. * prot, datë 29.6.2023**, informon se në bazë të verifikimeve të kryera rezulton se Altin Merizaj është trajtuar si anëtar i

familjes bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501 "Për tokën ", (në datën 01. 08.1991 figuron në gjendjen familjare) me kryefamiljar babain e tij, z. B. Merizaj. Në regjistrat e pasurive të paluajtshme janë hapur kartelat në emër të B. Merizaj, lloji i pasurisë F, dhe janë të pa certifikuara.

34. Në proces verbalin e datës 23.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se në lidhje me blerjen dhe mbjelljen e 145 rrënjë ullinjve në tokën bujqësore të marrë me ligjin nr. 7501, nga gjithë familja, këta ullinj janë blerë dhe mbjellë nga prindërit e tij me shpenzimet e tyre, me sa mban mend në vitin 2010, dhe ata janë kujdesur për ta. Vlera e blerjes së tyre ka qenë rreth 400 lekë një bimë, të gjithë rreth 60.000 lekë dhe shpenzimet për punimin e tokës, sistemimin, hapjen e gropave dhe mbjelljen e tyre kanë shkuar rreth 40.000 lekë, pra në total blerja dhe mbjellja kanë shkuar rreth 100.000 lekë (sqaruar në deklaratën e bërë nga prindërit). Nuk disponojnë dokumente, as ai dhe as prindërit për blerjen e ullinjve dhe as për punën e kryer për mbjelljen e tyre. Burimi ka qenë nga kursimet e gjithë familjes, e cila në atë kohë përbëhej dhe nga prindërit e tij, ku babai ka punuar si i vetëpunësuar në një punishte të vogël alumini në shtesën ngjitur me apartamentin e banimit. Nuk disponon dokumente, pasi nuk ka qenë i regjistruar apo licencuar si aktivitet privat. Sipas deklaratës së lëshuar nga babai, rezulton se gjatë viteve 2004 - 2011, që ka punuar në Tiranë, fitimet mujore nga kjo punë i ka pasur mesatarisht nga 50.000 deri 100.000 lekë në muaj. Sqaron se deri tani nuk ka përfituar të ardhura nga këta ullinj, por vetëm janë përdorur për nevoja familjare të prindërve dhe familjes së tij.

Bashkëlidhur deklaratës, subjekti ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

35. Deklaratë e thjeshtë nga B. Merizaj, i cili deklaron se rreth vitit 2010 kanë blerë dhe mbjellë 145 rrënjë ullinj në tokën bujqësore të marrë me ligjin 7501, në fshatin Aranitas, Mallakastër, me kursimet e tyre, të B. dhe Xh. Merizaj. Fara e blerjes së tyre, si dhe shpenzimet e tjera për mbjelljen, kanë qenë në vlerën totale rreth 100.000 lekë.

36. Në proces verbalin e datës 20.07.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se nuk disponon certifikatë pronësie për tokën bujqësore të deklaruar nga ana e tij. Sipërfaqja e tokës bujqësore është rreth 9.000 m², duke zbritur sipërfaqen e shitur prej 383 m². Për truallin theksoi se pavarësisht se mund të jetë shënuar në AMTP, ka qenë i përfituar më përpara, prandaj mendon se nuk është llogaritur në sipërfaqen totale të tokës bujqësore, të përfituar.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Certifikatë familjare, datë 08.09.2023,** lëshuar nga Njësia Administrative Aranitas, Mallakastër, përbërja familjare vitit 1992, në emër të B., Xh., Altin dhe A. Merizaj.

37. Konkluzion:

- ✓ Toka bujqësore me sipërfaqeje totale 9.480 m², është përfituar me AMTP nr. 1752 nga babai B. Merizaj, si përfaqësues i familjes bujqësore. Nga kjo tokë bujqësore rezulton se janë shitur 383 m² tokë arë (*trajtuar më poshtë*). Subjekti zotëron 1/4 pjesë takuese të kësaj pasurie. Trualli me sip. 250 m², nuk rezulton të jetë llogaritur në sipërfaqen

totale të tokës bujqësore të përfituar në AMTP, pavarësisht se është përcaktuar si tokë e përfituar.

- ✓ Ullinjtë e mbjellë në këtë tokë bujqësore, kanë qenë me burim nga të ardhurat e prindërve, dhe për të cilat nuk përfitohen të ardhura, por përdoren për nevoja familjare.

Pasuria nr. 3

🚦 Gjendje cash, 600.000 lekë.

Burimi i krijimit: Kursimet familjare nga paga ime dhe e bashkëshortes, shitja e një automjeti me targë ***, në datë 16.05.2020 me akt noterial nr. rep. ***, nr. kol. ***, me vlerë shitje 11.000 euro. Zotëron 50%.

38. Në proces verbalin e datës 23.6.2023 të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se në lidhje me deklarinimin e gjendjes cash në vlerën 600.000 lekë, ka përshkruar si burim të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes, si dhe shitja e një automjeti me targë **. Në pjesën e tij takuese ka deklaruar 50%, pasi duke qenë se burim i krijimit të kësaj vlere është dhe paga e bashkëshortes normalisht 50% janë të bashkëshortes edhe pse këto vlera monetare nuk i konsiderojmë të ndara por janë të gjithë familjes.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Nxjerrje Llogarie nga Raiffeisen Bank**, datë 07.03.2023, për llogari në lekë, në emër të Altin Merizaj, për periudhën 5.5.2005 - 7.3.2023, me balancë në vlerën 600.701 lekë.

39. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023**, konfirmon në emër të Altin Merizaj, llogari page në lekë, me gjendje në datë 10.3.2023, në vlerën 598.701 lekë, çelur në datë 05.05.2005, si dhe llogari në euro me gjendje 0.05 euro Konfirmon overdraft në lekë, me balancë në datë 10.03.2023, në vlerën - 65.000 lekë.
- **Llogari bankare page, pranë Raiffeisen Bank**, balanca në vlerën 600.701 lekë, më datë 07.03.2023, vlera e overdraft 65.000 lekë. Vlera e balancës së Llogarisë në datë 07.03.2023 është 600.701 lekë dhe 0.05 euro. Burimi: lekët që gjenden në llogari janë kursime nga paga, të lëna në llogari pa tërhequr. Zotëron 100 %

40. Konkluzion:

- ✓ Të ardhurat e realizuara justifikojnë gjenden cash të deklaruar. (*Shitja e automjetit trajtohet më poshtë*).
- ✓ Konstatohet se llogaria bankare është krijuar gjatë periudhës 2005 - 2023, me të ardhurat nga paga.

Deklarimet e subjektit:

Gjithashtu është bërë transferimi i pasurisë së paluajtshme “Sipërfaqe tokë bujqësore” prej 383 m², në fshatin ***, Mallakastër (në afërsi me pronën e përshkruar më sipër) marrë me ligjin nr. 7501, pas prishjes së Kooperativave Bujqësore. Kjo pronë është shitur faktikisht në vitin 2002, (datën se mbaj mend) shtetasve G. dhe P. B. dhe që nga kjo kohë e kanë poseduar dhe përdorur këta persona, por kontrata e shitblerjes për shkak të mungesës së certifikatës së pronësisë është bërë në datë 06.11.2017, me çmim shitje 50.000 lekë.

De fakto, kjo pronë, është shitur në vitin 2002, por *de jure* për shkak se noteri nuk mund të bënte aktin e shitjes, në nëntor 2017, pa transferuar vlerën e shitjes së kësaj prone në një llogari bankare, nga blerësi G. B. është bërë derdhja e lekëve sipas çmimit të shitjes në një numër llogarie në Credins Bank, lekë të cilat janë marrë sërish prej tij.

Ky veprim është kërkuar nga noteri dhe është bërë në mirëkuptim ndërmjet blerësit G. B. dhe babait tim B. M. Vlerën e kësaj prone nuk mund ta përcaktoj, pasi kjo tokë është marrë me ligjin 7501, pas prishjes së Kooperativave Bujqësore.

Çmimi i shitjes është 50.000 lekë. Zotëron 0 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **AMTP, nr. ***,** ku konfirmon se shtetasi B. Merizaj, nga fshati Aranitas, ka përfituar tokë bujqësore gjithsej 9.480 m², nga të cilat arë 7.900 m², pemëtore 900 m², ullishte 680 m² dhe truall 250 m².
- **Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme nr. *** rep, nr. *** kol,** datë 06.11.2017, me palë shitëse B., Xh., Altin dhe A. Merizaj, pronarë në pjesë të barabartë, dhe palë blerëse G. dhe P. B., me objekt shitjen e një trualli me sip. 251 m², nga kjo ndërtesë 89 m², pasuri e pajisur me certifikatë pronësie, e ndodhur në fshatin ***, Mallakastër, në vlerën 1.950.000 lekë, depozituar në llogari të Credins Bank.
- **Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme nr. *** rep, nr. *** kol, datë 06.11.2017,** me palë shitëse B., Xh., Altin dhe A. Merizaj, pronarë në pjesë të barabartë, dhe palë blerëse G. dhe P. B., me objekt shitjen e një toke arë me sip. 383 m², pasuri e pajisur me certifikatë pronësie, e ndodhur në fshatin ***, Mallakastër, në vlerën 50.000 lekë, depozituar në llogari të Credins Bank.
- **ASHK, zyra Vendore Mallakastër me shkresën nr. *** prot, datë 29.6.2023,** informon se në bazë të verifikimeve të kryera, rezulton se Altin Merizaj është trajtuar si anëtar i familjes bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501 "Për tokën", (në datën 1.8.1991 figuron në gjendjen familjare), me kryefamiljar babain e tij B. Merizaj. Në regjistrat e pasurive të paluajtshme janë hapur kartelat në emër të B. Merizaj, lloji i pasurisë F, dhe janë të pa certifikuara.

41. Në procesverbalin e datës 23.06.2023 të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se lidhur me shitjen nga B., Xh., Altin dhe A. Merizaj, të shtëpisë dhe truallit në fshatin ***, Mallakastër ashtu si e ka shpjeguar dhe në deklaram, kjo shtëpi në fakt është shitur që në vitin 2002, janë marrë lekët e shitjes prej 2.000.000 lekë në këtë moment, ndërsa veprimet noteriale janë bërë në vitin 2017, vit në të cilin është lëshuar për herë të parë certifikata e pronësisë për këtë pronë. Në momentin e shitjes së

kësaj prone në vitin 2002, lekët janë marrë në dorë nga babai B. Merizaj dhe nuk kanë kaluar në bankë, nuk disponon asnjë faturë apo dokument që ta vërtetojë këtë fakt. Pas kërkesës për dokumentacion ka komunikuar në telefon me blerësin e kësaj prone, shtetasin G. B., i cili i ka shpjeguar se ndodhej në Greqi.

- Libreza e dritave edhe pas shitjes në fakt në vitin 2002 ka vazhduar të figurojë në emër të babait të tij, pasi pa u bërë akti notarial i shitjes, nuk mund të ndërrohej më parë.
- Nga ana e noterit është kërkuar kalimi i vlerës së shitjes nga blerësi në llogarinë e tij në Credins Bank dhe më pas do kalonin te shitësi, pasi e kishte detyrim ligjor. Kështu kanë vepruar, shtetasi G. B. ka mbyllur vlerën e lekëve sipas çmimit të shitjes në llogari e noterit të Credins Bank, të cilat më pas janë marrë nga babai B. Merizaj dhe i janë kaluar shtetasit G. B., gjë e cila shpjegohet dhe në deklaratën e nënshkruar nga shtetasja P. B.
- Sipas dokumentit të marrë nga banka, shuma e parave nga Credins Bank janë tërhequr nga babai në datë 07.11.2017, të njëjtën datë që është nënshkruar akti i shitblerjes dhe janë tërhequr në degën e Bankës në Mallakastër, që tregon se i janë dhënë direkt shtetasit G. B.
- Përveç deklaratës së P. B. dhe dokumentit të Bankës Credins, nuk ka dhe nuk mund të siguroj dokumentacion tjetër. Lidhur me faktin se sa ka përfituar subjekti nga shitja e kësaj pasurie dhe destinacioni i shumës së përdorur të kësaj vlere, shpjegon se vlera e shitjes së kësaj pasurie është administruar nga ana e prindërve dhe destinacioni i tyre ka qenë për blerjen e apartamentit në Tiranë, në rrugën "****" në vitin 2004.

42. Bashkëlidhur deklaratës:

- **Deklaratë e thjeshtë nga B. Merizaj**, viti 2023, i cili deklaron se në vitin 2002 kanë shitur një shtëpi private, truallin dhe një sipërfaqe toke në fshatin ***, Mallakastër, tek G. B. dhe bashkëshortja e tij P. B., me çmim 2.000.000 lekë, të cilat i janë dhënë në dorë nga blerësi dhe janë administruar nga B. Merizaj si krye familjar. Për këtë shitje nuk kanë bërë akt notarial në këtë moment, pasi shtëpia ishte ndërtuar para viteve 1990 dhe nuk kishte certifikatë pronësie, ndërsa sipërfaqja e tokës ishte marrë me ligjin 7501, edhe kjo nuk kishte certifikatë pronësie, ndërsa lekët e çmimit të shitjes i janë dhënë në mirëbesim nga blerësi, për shkak të njohjes që kanë prej vitesh. Kontrata e shitblerjes për këtë pronë është bërë në vitin 2017, kur doli për herë të parë certifikata e pronësisë. Nga ana e noterit i është kërkuar kalimi i vlerës nga blerësi në llogarinë e tij në Credins Bank, dhe më pas kalimi tek shitësi, pasi e kishte detyrim ligjor. Kanë rënë dakord me blerësin, i cili ka mbyllur vlerën e lekëve dhe pasi janë tërhequr nga B. Merizaj i janë dhënë shtetasit G. B.
- **Deklaratë noteriale nr. *** rep, datë 17.06.2023**, me palë deklaruese P. B., e cila deklaron se bashkëshorti i saj G. B. ndodhet në Greqi, dhe pas konsultimit dhe me të në telefon, deklaron se në vitin 2002 ajo dhe bashkëshorti i saj kanë blerë nga shtetasit B., Xh., Altin dhe A. Merizaj një shtëpi private së bashku me truallin prej 251 m² dhe një sipërfaqe prej 383 m² tokë arë, në fshatin ***, Mallakastër. Kjo pronë është blerë në vlerën rreth 2.000.000 lekë, të cilat i janë dhënë në dorë që në këtë moment, por për shkak se pala shitëse nuk dispononte dokumentacion pronësie, kemi rënë dakord që akti notarial të bëhej në një moment tjetër, për shkak të marrëdhënieve miqësore. Në vitin 2017, ajo së bashku me bashkëshortin e saj dhe familja e B. Merizaj, duke qenë se kishte dalë certifikata e pasurisë, kanë bërë kontratën e shitblerjes. Mesa i kujtohet noteri i ka kërkuar që të bëhej

kalimi i vlerës së shitjes, dhe më pas bashkëshorti i saj ka hedhur në llogarinë e noterit vlerën 2.000.000 lekë tek Credins Bank, të cilat pas kryerjes së veprimeve noteriale janë marrë sërish nga ana e tyre.

- **Nxjerrje llogarie nga Credins Bank**, datë 16.06.2023, për llogari në lekë, në emër të B. Merizaj, ku konstatohet se në datën 06.11.2017 kreditohet vlera 1.950.000 lekë, me përshkrimin "*Shitje toke ndërtesë, kontratë nr. *** rep, nr. *** kol, datë 6.11.2017*", vlerë e cila është tërhequr nga B. Merizaj në të njëjtën datë, me përshkrimin "*Të ardhura nga shitje pasurie.*"

43. Analizimi i provave të paraqitura:

Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me shitjen e pasurive: shtëpi me sip. 89 m² + truall 251 m², si dhe tokë arë me sip. 383 m², në fshatin ***, Mallakastër, deklaruar si burim financimi për blerjen a apartamentit në rr. "****", Tiranë, në vitin 2004, në emër të prindërve. Kontrata e shitjes është e vitit 2017. Sipas sqarimeve dhe deklaratave të paraqitura nga subjekti, konstatohet se shitja është realizuar që në vitin 2002.

44. Qëndrimi i trupës së vlerësimit:

- ✓ **Trupa vlerësimit ka marrë në analizë pasurinë me sip. 251 m², nga objekt banimi me sip. 89 m² e deklaruar nga subjekti si të shitur në vitin 2002, por për shkaqe të përligjura (prona nuk ka patur certifikate pronësie dhe në vitin 2017 kjo pronë është pajisur me certifikate pronësie), kontrata është mbajtur në bona fides para noterit në vitin 2017.**

PASURI TË LUAJTSHME

- ✚ **Automjet i markës Mercedes Benz**, modeli 211 E Class, 200 CDI, me targa ***, viti i prodhimit 2004, blerë në vitin 2010 (datën se mbaj mend pasi nuk kam ruajtur dokumentin e blerjes, për disa kohë makina është mbajtur e pa zhdoganuar dhe pa targuar).

Blerë me çmim rreth 7.000 euro dhe 220.000 lekë ka kushtuar zhdoganimi. Kjo makinë në datë 03.02.2014 është shitur sipas kontratës noteriale me çmim 5.000 euro. Zotëron 0 %.

Burimi i të ardhurave: Paga e tij dhe e bashkëshortes.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **Vërtetim nga DPSHTRR, datë 03.03.2023**, ku vërteton se Altin Merizaj, ka patur në pronësi mjetin me targë ***. Aktualisht nuk ka mjet të regjistruar në emër të tij.
- **Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 03.02.2014**, me palë shitës Altin Merizaj dhe blerës I. P., me objekt shitjen e një automjeti tip Mercedes Benz, E200 Cdi, me targë ***, në vlerën 5.000 euro, vlerë e paguar jashtë zyrës noteriale. DPSHTRR me shkresën nr. *** prot, datë 12.5.2023, konfirmon në emër të Altin Merizaj, mjetin me targë ***, tip Mercedes Benz, E200 Cdi, shitur sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol,

datë 3.2.2014, në vlerën 5.000 euro. Ky automjet sipas dokumentacionit bashkëlidhur, (në gjuhën Gjermane), rezulton të jetë blerë në datë 26.12.2011, në vlerën 7.000 euro.

45. Në procesverbalin e datës 23.06.2023 të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se burimi i përdorur për blerjen e automjetit me targë ***, ka qenë nga kursimet familjare të tij dhe të bashkëshortes, nga të ardhurat e përbashkëta dhe nga paga si punonjës në Policinë e Shtetit.

46. Në proces verbalin e datës 20.07.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, në lidhje me automjetin e blerë në vlerën totale prej 1.200.000 lekë, subjekti ka sqaruar se është blerë në vlerën 7.000 euro + doganë në vlerën 220.000 lekë, në datë 28.12.2011, me burim të ardhurat e disponueshme gjatë vitit 2011 dhe konkretisht; të ardhura familjare nga pagat, të ardhura nga shitja e apartamentit të prindërve, huamarrje, dhe kredi bankare. Automjeti me targë ***, rezulton të jetë blerë në vitin 2011 dhe shitur në vitin 2014.

✚ **Automjet i markës Mercedes Benz**, modeli ML 270 CDI, me targa ***, viti i prodhimit 2005, blerë në datë 09.02.2014 me çmim 300.000 lekë, paguar zhdoganimi për të cilin se mbaj mend vlerën dhe nuk disponoj dokument.

Kjo makinë në datë 11.11.2015 është shitur sipas kontratës noteriale me çmim 6.000 euro. Zotëron 0 %.

Burimi i të ardhurave: Kursimet familjare dhe shitja e automjetit të mëparshëm me targa ***.

47. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **Vërtetim nga DPSHTRR, datë 03.03.2023**, ku vërtetohet se Altin Merizaj, ka patur në pronësi mjetin me targë ***. Aktualisht nuk ka mjet të regjistruar në emër të tij.
- **Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 09.02.2014**, me palë shitëse B. K. dhe blerës Altin Merizaj, për automjet tip Daimler Chrysler, në vlerën 300.000 lekë, shumë të cilën do ta paguajë me regjistrimin e automjetit.
- **Kontratë shit-blerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 11.11.2015**, me palë shitëse Altin Merizaj dhe blerës F. M., për automjet tip Daimler Chrysler, me targa ***, viti 2005, në vlerën 6.000 euro, vlerë e paguar jashtë zyrës noteriale.
- **DPSHTRR me shkresën nr. *** prot, datë 12.05.2023**, konfirmon në emër të Altin Merizaj, mjetin me targë ***, tip Daimler Chrysler, viti 2005, blerë sipas deklaratës doganore, eksportues B. K., datë 17.02.2015, në vlerën 2.000 euro dhe doganë 60.218 lekë dhe shitur sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, datë 11.11.2015, në vlerën 6.000 euro.

48. Në proces-verbalin e datës 23.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se burimi i të ardhurave për blerjen e këtij automjeti është nga kursimet familjare dhe shitja e automjetit të mëparshëm me targa ***, shitur në datë 03.02.2014.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Kontratë kredie konsumatore, datë 20.06.2023**, me palë Raiffeisen Bank dhe Altin Merizaj, për marrjen e një kredie në vlerën 400.000 lekë, për arsye personale, me afat 48 muaj.
- **Urdhër pagese, tatim mbi të ardhurat individuale**, nga Raiffeisen Bank, datë 21.06.2023, pagesë detyrimi për periudhën janar - dhjetor 2015, vlera 70.686 lekë.
- **Mandat pagese nga Raiffeisen Bank**, datë 21.06.2023, ku konstatohet se Altin Merizaj paguan vlerën 70.686 lekë, në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me përshkrimin "Tatim mbi të ardhurat individuale janar - dhjetor 2015.
- **Urdhër pagese, tatim mbi të ardhurat individuale**, nga Raiffeisen Bank, datë 22.06.2023, pagesë gjobe, deklaram i vonuar, në vlerën 51.111 lekë, periudha janar - dhjetor 2015.
- **Mandat pagese nga Raiffeisen Bank**, datë 22.06.2023, ku konstatohet se Altin Merizaj paguan vlerën 51.111 lekë, në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me përshkrimin "Gjobë + interes, janar - dhjetor 2015.

49. Konkluzion:

- ✓ Automjeti me targë ***, rezulton të jetë blerë në vitin 2014 dhe shitur në vitin 2015. Burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit është nga kursime familjare dhe shitja e automjetit të mëparshëm me targa ***, në vlerën 5.000 euro.
- ✓ Subjekti ka kryer pagesën e detyrimeve tatimore për këtë automjet pranë organeve tatimore në vlerën totale rreth 122.000 lekë.

- ✚ **Automjet i markës Mercedes Benz**, modeli 211 E class 200 CDI, me targa ***, viti i prodhimit 2007, blerë në datë 21.11.2015, me çmim 5.000 euro. Kjo makinë në datë 07.09.2016 është shitur sipas kontratës noteriale me çmim 8.500 euro. Zotëron 0%.

Burimi i të ardhurave: kursimet familjare dhe shitja e automjetit të mëparshëm me targa ***.

50. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **Vërtetim nga DPSHTRR, datë 03.03.2023**, ku vërteton se Altin Merizaj, ka patur në pronësi mjetin me targë ***. Aktualisht nuk ka mjet të regjistruar në emër të tij.
- **Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol**, datë 21.11.2015, me palë shitëse S. D. dhe blerës Altin Merizaj, për automjet tip Mercedes Benz, E200 Cdi, viti 2007, në vlerën 5.000 euro, vlerë e likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- **Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 7.9.2016**, me palë shitëse Altin Merizaj dhe blerës F. V., për automjet tip Mercedes Benz, E 200 Cdi, me targë ***, Viti 2007, në vlerën 8.500 euro, vlerë e likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- **DPSHTRR me shkresën nr. *** prot, datë 12.5.2023**, konfirmon në emër të Altin Merizaj, mjetin me targë ***, tip Mercedes Benz E200 Cdi, blerë sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, në vlerën 5.000 euro dhe shitur sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, datë 7.9.2016, në vlerën 8.500 euro.

51. Në proces verbalin e datës 23.6.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se burimi i të ardhurave për blerjen e këtij automjeti është nga kursimet familjare dhe shitja e automjetit të mëparshëm me targa ***, shitur në datë 11.11.2015.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Kontratë kredie konsumatore, datë 20.06.2023,** me palë Raiffeisen Bank dhe Altin Merizaj, për marrjen e një kredie në vlerën 400.000 lekë, për arsye personale, me afat 48 muaj.
- **Urdhër pagese, tatim mbi të ardhurat individuale,** nga Raiffeisen Bank, datë 21.06.2023, pagesë detyrimi për periudhën janar - dhjetor 2016, vlera 72.725 lekë.
- **Mandat pagese nga Raiffeisen Bank, datë 21.06.2023,** ku konstatohet se Altin Merizaj paguan vlerën 72.725 lekë, në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me përshkrimin "Tatim mbi të ardhurat individuale janar - dhjetor 2016.
- **Urdhër pagese, tatim mbi të ardhurat individuale,** nga Raiffeisen Bank, datë 22.06.2023, pagesë gjobe, deklaram i vonuar, në vlerën 47.784 lekë, periudha janar - dhjetor 2016.
- **Mandat pagese nga Raiffeisen Bank, datë 22.06.2023,** ku konstatohet se Altin Merizaj paguan vlerën 47.784 lekë, në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me përshkrimin "Gjobë + interes, janar - dhjetor 2016" .

52. Konkluzion:

- ✓ Automjeti me targë ***, rezulton të jetë blerë në vitin 2015 dhe shitur në vitin 2016. Burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit është nga kursime familjare dhe shitja e automjetit të mëparshëm, me targë ***, në vlerën 6.000 euro.
- ✓ Subjekti ka kryer pagesën e detyrimeve tatimore për këtë automjet pranë organeve tatimore në vlerën totale rreth 120.000 lekë.

🚗 **Automjet i markës Mercedes Benz,** modeli 203 C Class 220 CDI, me targa ***, Viti i prodhimit 2004, blerë në datë 03.04.2017, me çmim 3.000 euro, regjistruar në pronësinë time, por është përdorur nga bashkëshortja. Kjo makinë në datë 09.09.2019 është shitur sipas kontratës noteriale me çmim 4.000 euro. Zotëron 0 %.

Burimi i të ardhurave: Kursimet familjare dhe shitja e automjetit me targa ***.

53. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **Vërtetim nga DPSHTRR, datë 03.03.2023,** ku vërteton se Altin Merizaj, ka patur në pronësi mjetin me targë ***. Aktualisht nuk ka mjet të regjistruar në emër të tij.
- **Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 09.09.2019,** me palë shitëse Altin Merizaj dhe blerës K. B., për automjet tip Daimler Chrystler, (220 Cdi, Viti 2004, me targa ***, në vlerën 4.000 euro, shumë e paguar përpara nënshkrimit të kësaj kontrate.
- **DPSHTRR me shkresën nr. *** prot, datë 12.5.2023,** konfirmon në emër të Altin Merizaj, mjetin me targë ***, tip Daimler Chrystler, C220 Cdi, Viti 2004, blerë sipas

kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, datë 3.4.2017, në vlerën 3.000 euro dhe shitur sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, datë 9.9.2019, në vlerën 4.000 euro.

54. Në proces verbalin e datës 23.6.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se burimi i të ardhurave për blerjen e këtij automjeti është nga kursimet familjare dhe shitja e automjetit të mëparshëm në pronësi të bashkëshortes Ford Focus, me targa ***, shitur në datë 21.2.2017.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Kontratë kredie konsumatore, datë 20.6.2023,** me palë Raiffeisen Bank dhe Altin Merizaj, për marrjen e një kredie në vlerën 400.000 lekë, për arsye personale, me afat 48 muaj.
- **Urdhër pagese, tatim mbi të ardhurat individuale,** nga Raiffeisen Bank, datë 21.6.2023, pagesë detyrimi për periudhën janar - dhjetor 2019, vlera 11.859 lekë. Mandat pagese nga Raiffeisen Bank, datë 21.6.2023, ku konstatohet se Altin Merizaj paguan vlerën 11.859 lekë, në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me përshkrimin "Tatim mbi të ardhurat individuale janar - dhjetor 2019.
- **Urdhër pagese, tatim mbi të ardhurat individuale,** nga Raiffeisen Bank, datë 22.06.2023, pagesë gjobe, deklaram i vonuar, në vlerën 9.641 lekë, periudha janar - dhjetor 2019.
- **Mandat pagese nga Raiffeisen Bank,** datë 22.06.2023, ku konstatohet se Altin Merizaj paguan vlerën 9.641 lekë, në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me përshkrimin "Gjobë + interes, janar - dhjetor 2019.

55. Konkluzion:

- ✓ Automjeti me targë ***, rezulton të jetë blerë në vitin 2017 dhe shitur në vitin 2019. Burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit është kursime familjare dhe shitja e automjetit të mëparshëm në pronësi të bashkëshortes me targa ***, në vlerën 1.500 euro.
- ✓ Subjekti ka kryer pagesën e detyrimeve tatimore për këtë automjet pranë organeve tatimore në vlerën totale 21.500 lekë.

✚ **Automjet i markës Volkswagen,** modeli Touareg, me targa ***, viti i prodhimit 2007, blerë në datë 19.07.2017 me çmimin 4.000 euro. Kjo makinë në datë 15.8.2018 është shitur sipas kontratës noteriale çmim 990.000 lekë. Zotëron 0 %.

Burimi i të ardhurave: kursimet familjare dhe shitja e automjetit të mëparshëm me targa ***.

56. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **Vërtetim nga DPSHTRR, datë 03.03.2023,** ku vërteton se Altin Merizaj, ka patur në pronësi mjetin me targë ***. Aktualisht nuk ka mjet të regjistruar në emër të tij.
- **Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 19.07.2017,** me palë shitëse G. H. dhe blerës Altin Merizaj, për automjet tip Volkswagen Touareg, Viti 2007, me targë ***, në vlerën 4.000 euro, shumë e paguar përpara nënshkrimit të kësaj kontrate.

- **Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 15.08.2018**, me palë shitëse Altin Merizaj dhe blerës N. M., për automjet tip Volkswagen Touareg, me targë ***, në vlerën 990.000 lekë, shumë e paguar përpara nënshkrimit të kësaj kontrate.
- **DPSHTRR me shkresën nr. *** prot, datë 12.05.2023**, konfirmon në emër të Altin Merizaj, mjetin me targë ***, tip Volkswagen Touareg, Viti 2007, blerë sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, datë 19.07.2017, në vlerën 4.000 euro dhe shitur sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, datë 15.08.2018, në vlerën 990.000 lekë.

57. Në proces verbalin e datës 23.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit është nga kursimet familjare dhe shitja e automjetit të mëparshëm me targa ***, shitur në datë 07.09.2016.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Kontratë kredie konsumatorë, datë 20.6.2023**, me palë Raiffeisen Bank dhe Altin Merizaj, për marrjen e një kredie në vlerën 400.000 lekë, për arsye personale, me afat 48 muaj.
- **Urdhër pagese, tatim mbi të ardhurat individuale**, nga Raiffeisen Bank, datë 21.6.2023, pagesë detyrimi për periudhën janar - dhjetor 2018, vlera 69.006 lekë.
- **Mandat pagese nga Raiffeisen Bank**, datë 21.6.2023, ku konstatohet se Altin Merizaj paguan vlerën 69.006 lekë, në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me përshkrimin "Tatim mbi të ardhurat individuale janar - dhjetor 2018".
- **Urdhërpagese, tatim mbi të ardhurat individuale**, nga Raiffeisen Bank, datë 22.6.2023, pagesë gjobe, deklaram i vonuar, në vlerën 37.047 lekë, periudha janar - dhjetor 2018.
- **Mandat pagese nga Raiffeisen Bank, datë 22.06.2023**, ku konstatohet se Altin Merizaj paguan vlerën 37.047 lekë, në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me përshkrimin "Gjobë + interes, janar - dhjetor 2018".

58. Konkluzion:

- ✓ Automjeti me targë ***, rezulton të jetë blerë në vitin 2017 dhe shitur në vitin 2018. Burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit është nga kursime familjare dhe shitja e automjetit të mëparshëm me targa *** në vlerën 8.500 euro.
- ✓ Subjekti ka kryer pagesën e detyrimeve tatimore për këtë automjet pranë organeve tatimore në vlerën totale 106.000 lekë.

🚗 **Automjeti i markës Mercedes Benz**, modeli 164 ML 320 Bluetec, me targa ***, viti i prodhimit 2009, blerë në datë 23.08.2018 me çmim 870.000 lekë. Kjo makinë në datë 16.05.2020 është shitur sipas kontratës noteriale me çmim 11.000 euro. Zotëron 0%.

Burimi i të ardhurave: kursimet familjare dhe shitja e automjetit me targa ***.

59. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **Vërtetim nga DPSHTRR, datë 03.03.2023**, ku vërtetohet se Altin Merizaj, ka patur në pronësi mjetin me targë ***. Aktualisht nuk ka mjet të regjistruar në emër të tij.
- **Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 23.08.2018**, me palë shitëse O. K. dhe blerës Altin Merizaj, për automjet tip Mercedes Benz, me targë ***, në vlerën 870.000 lekë, shumë e likuiduar totalisht nga blerësi.
- **Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 16.05.2020**, me palë shitëse Altin Merizaj dhe blerës A. K., për automjet tip Mercedes Benz, ML 320, viti 2009, me targë ***, në vlerën 11.000 euro, vlerë e paguar jashtë zyrës noteriale. Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 15.8.2018, me palë shitëse Altin Merizaj dhe blerës N. M., për automjet tip Volkswagen Touareg, me targë ***, në vlerën 990.000 lekë.
- **DPSHTRR me shkresën nr. *** prot, datë 12.5.2023**, konfirmon në emër të Altin Merizaj, mjetin me targë ***, tip Mercedes Benz, ML 320, viti 2009, blerë sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, datë 23.08.2018, në vlerën 870.000 lekë dhe shitur sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, datë 16.05.2020, në vlerën 11.000 euro.

60. Në proces-verbalin e datës 23.06.2023 të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit është nga kursimet familjare dhe shitja e automjetit të mëparshëm me targa ***, shitur në datë 15.08.2018.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Kontratë kredie konsumatore, datë 20.06.2023**, me palë Raiffeisen Bank dhe Altin Merizaj, për marrjen e një kredie në vlerën 400.000 lekë, për arsye personale, me afat 48 muaj.
- **Urdhër pagese, tatim mbi të ardhurat individuale**, nga Raiffeisen Bank, datë 21.06.2023, pagesë detyrimi për periudhën janar - dhjetor 2020, vlera 73.061 lekë.
- **Mandat pagese nga Raiffeisen Bank, datë 21.6.2023**, ku konstatohet se Altin Merizaj paguan vlerën 73.061 lekë, në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me përshkrimin "Tatim mbi të ardhurat individuale janar - dhjetor 2020".
- **Urdhër pagese, tatim mbi të ardhurat individuale**, nga Raiffeisen Bank, datë 22.06.2023, pagesë gjobe, deklaram i vonuar, në vlerën 29.897 lekë, periudha janar - dhjetor 2020.
- **Mandat pagese nga Raiffeisen Bank, datë 22.06.2023**, ku konstatohet se Altin Merizaj paguan vlerën 29.897 lekë, në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me përshkrimin "Gjobë + interes, janar - dhjetor 2020".

61. Konkluzion:

- ✓ Automjeti me targë ***, rezulton të jetë blerë në vitin 2018 dhe shitur në vitin 2020. Burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit është nga kursime familjare dhe shitja e automjetit të mëparshëm me targa ***, në vlerën 990.0000 lekë.
- ✓ Subjekti ka kryer pagesën e detyrimeve tatimore për këtë automjet pranë organeve tatimore në vlerën totale 103.000 lekë.

62. Trupa e vlerësimit në analizë të deklarimeve të automjeteve nga ana e subjektit lidhur me blerje/shitjet është konstatuar se subjekti ka përfituar të ardhura nga diferenca e çmimit, për të cilat ligji parashikon pagesën e detyrimeve tatimore, konkretisht me targa *, ***, ***, *** dhe ***.**

63. Në lidhje me pagesat e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e automjeteve të mësipërme, konkretisht me targa *, ***, ***, *** dhe ***, (diferenca midis çmimit të blerjes dhe shitjes), subjekti sqaroi, se nuk ka paguar detyrimet tatimore në momentin e shitjes së tyre, pasi nuk ka patur dijeni dhe njohuri ligjore që duhet të paguante tatim mbi të ardhurat e përfituara nga shitja. Subjekti sqaron se automjetet nuk janë blerë me qëllim tregtie për të fituar, por janë blerë dhe përdorur nga ana e tij dhe më pas janë shitur. Në momentin që është njohur me këtë fakt, ka kryer procedurat e vetë deklarimit dhe ka bërë pagesën sipas urdhrave të pagesave dalë në sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për gjambat dhe interesat. Burimi i të ardhurave për pagesën për tatimin mbi të ardhurat nga shitja e këtyre automjeteve është nga kredia e marrë në Raiffeisen Bank në datë 20.06.2023, me vlerë 400.000 lekë. Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion në lidhje me pagesat e detyrimeve tatimore. që rrjedhin nga të ardhurat e krijuara nga diferenca e çmimit të shitjes - blerjes së automjeteve të sipërcituara, konkretisht me targa ***, ***, ***, *** dhe *** në vlerën totale rreth 473.000 lekë.**

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur.

64. Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.

- Shpenzimet për ujë, (janar - dhjetor 2022), 26.477 lekë.
- Shpenzimet për energji elektrike (janar - dhjetor 2022), 68.877 lekë.
- Shpenzimet për telefoninë fikse (janar - dhjetor 2022), 33.000 lekë.
- Shpenzime për telefonin celular +3556941***, 2.000 lekë
- Shpenzime për telefonin celular +3556941***, 8.400 lekë

✓ **Total 138.754 lekë.**

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Librezë e UKT, Tiranë, për Altin Merizaj, kontrata nr. *****, adresa pallati ***, shkalla **, ap. **, ku konfirmohen pagesat për vitin 2022, në vlerën totale rreth 26.000 lekë.
- **Librezë e OSHE, për Altin Merizaj**, ku konfirmohen pagesat për vitin 2022, në vlerën totale rreth 68.000 lekë.

- **FSHU me shkresën nr. *** prot, datë 11.05.2023**, konfirmon se me gjeneralitetet Altin Merizaj, rezulton e lidhur një kontratë për shërbim furnizimi, në instancën Tiranë, adresa "****", nr. Pagesat për periudhën dhjetor 2021 - dhjetor 2022, janë në vlerën totale 83.912 lekë.
- **UKT Tiranë me shkresën nr. *** prot, datë 12.06.2023**, konfirmon në emër të Altin Merizaj, kontratën me nr. ***, për objektin me adresë në rrugën "****" me status aktiv, me detyrime të likuiduara deri në muajin mars 2023. Bashkëlidhur certifikata e pasurisë me nr. ***, me sip. 90.7 m², e ndodhur në rrugën "****", nr. ***, Shk. *, ap. **, Tiranë. Pagesat e kryera për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, janë në vlerën totale 26.289 lekë.
- **Vodafone, me shkresën nr. *** prot, datë 13.7.2023**, konfirmon se në emër të Komisarariatit të Policisë, nr. 1, Altin Merizaj numri celular 3556941***, nga viti 2007 (faturimi për vitin 2022 është në vlerën 8.700 leke), si dhe në emër të Drejtorisë së Policisë Qarku Durrës, L. Merizaj, numri celular +3556941*** (faturimi për vitin 2022 është në vlerën 8.151 lekë). Në lidhje me kontratat e ish shoqërisë Abcom, bën me dije se po bëhet kërkimi në arkiv. Sipas tabelës bashkëlidhur Altin Merizaj, figuron klient, me faturim vjetor në vlerën 29.792 lekë.
- **One Albania sha me shkresën nr. 23/49 prot, datë 01.08.2023**, konfirmon në emër të Altin Merizaj, , numrat +35568***, +35568***, dhe në emër të L. Merizaj, numrin 35568**. Totali i shpenzimeve për vitin 2022, për numrin +35568*** është në vlerën 1.751 lekë dhe numrin +35568*** është 4.424 leke.
- **Shpenzimet e deklaruara për ujë + drita + telefoni + internet** gjatë periudhës së sipërcituar. me kontrata në emër të subjektit dhe bashkëshortes, rezultojnë në total rreth 146.000 lekë.

SHPENZIME PËR UDHËTIME

65. Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022:

- Udhëtim jashtë vendit në Mal të Zi, për arsye pune, konkretisht si një grup pune nga Departamenti i Policisë Kufitare, në Drejtorisë e Përgjithshme të Policisë për një takim me palën Malazeze në Podgoricë, vajtje ardhje brenda datës 20.12.2022 nga pika e kalimit kufitar Hani i Hotit. Udhëtimi dhe të gjitha shpenzimet kanë qenë të paguara nga organizatorët dhe nuk kam patur shpenzime personale.
- Udhëtim jashtë vendit në Greqi, në Parga, për arsye turistike, vajtje ardhje brenda datës 09.08.2022 me automjet nga pika e kalimit kufitar Qafë Bota. Shpenzimet kanë shkuar rreth 150 euro.
- Udhëtim për pushime në Turqi, Antalia me familjes, (bashkëshorten dhe dy fëmijët). Nisja nga Rinasi, datë 02.07.2021, kthimi po nga Rinasi datë 09.07.2021. Prenotimi dhe pagesa për këto pushime janë bërë te agjencia e udhëtimeve *** Travel & Tours, ku kanë qenë të gjitha të përfshira, udhëtim akomodim, ushqim etj. dhe kanë kushtuar rreth 1.500 euro.
- ✓ **Total 1.650 euro.**

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Faturë tatimore** nr. ***, datë 21.06.2021, lëshuar nga *** shpk, për L. Merizaj, në vlerën 92.625 lekë (750 euro), me përshkrimin "paketë Antalia Faturë tatimore nr.***, datë 21.6.2021, lëshuar nga *** shpk, për L. Merizaj, në vlerën 92.625 lekë (750 euro), me përshkrimin "paketë Antalia".
- **Subjekti sqaroi** se për udhëtimin në Malin e Zi vajtje-ardhje, brenda datës 20.12.2023, ashtu si e ka shpjeguar në deklaram, nuk ka pasur asnjë shpenzim, pasi udhëtimi është bërë me automjete të Policisë së Shtetit, ndërsa dreka e punës e paguar nga organizatorët.
- **Për udhëtimin në Greqi**, Parga vajtje-ardhje brenda datës 09.08.2022, ashtu si e ka shpjeguar në deklaratë shpenzimet kanë qenë rreth 150 Euro, shpenzime që kanë të bëjnë me pagesa dreke, kafe, karburant makine.
- **Printimi nga Sistemi Tims**, për të dhënat mbi hyrjet dhe daljet nga territori Shqiptar, të shtetasit Altin Merizaj. Për periudhën 2020 - 2022, të dhënat janë si më poshtë: Dalje në datë 02.07.2021 (Charter, Rinas) - Hyrje në datë 09.07.2021 (Charter-Antalia, Rinas).
- **Dalje** në datë 09.08.2022 (Qafë Botë) - Hyrje datë 09.08.2022 (Qafë Botë).
- **Dalje** në datë 20.12.2022 (Hani i Hotit), - Hyrje në datë 20.12.2022 (Hani i Hotit).
- **Për vitin 2019** subjekti ka lëvizur në pikat kufitare Morina dhe Qafë Thana.
- **Për vitin 2020** nuk rezulton të ketë patur lëvizje.
- **Printimi nga Sistemi Tims**, për të dhënat mbi hyrjet dhe daljet nga territori Shqiptar, të shtetasit A. Merizaj. Për periudhën 2020 - 2022, të dhënat janë si më poshtë: Dalje në datë 02.07.2021 (Charter, Rinas) - Hyrje në datë 09.07.2021 (Charter-Antalia, Rinas).
- **Dalje** në datë 09.08.2022 (Qafë Botë) - Hyrje datë 09.08.2022 (Qafë Botë).
- **Printimi nga Sistemi Tims**, për të dhënat mbi hyrjet dhe daljet nga territori Shqiptar, të shtetasit A. Merizaj. Për periudhën 2020 - 2022, të dhënat janë si më poshtë: Dalje në datë 02.07.2021 (Charter, Rinas) - Hyrje në datë 09.07.2021 (Charter-Antalia, Rinas).
- **Dalje** në datë 9.8.2022 (Qafë Botë) - Hyrje datë 9.8.2022 (Qafë Botë).

66. Konkluzion:

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar sa i përket hyrje - daljeve nga R.SH., gjatë periudhës 2020 - 2022 të subjektit dhe personave të lidhur me të.

67. Subjekti deklaroi shpenzimet për arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vetore, si dhe kohën e studimeve sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit nr. 12/2018:

- Djali A. Merizaj ka përfunduar shkollën 9 vjeçare "Ali ***" Tiranë dhe aktualisht vazhdon shkollën e mesme profesionale "Hermann ***" në Sauk, Tiranë. Vajza A. Merizaj vazhdon shkollën 9 vjeçare "Ali ***", Tiranë.
- Djali A. Merizaj ka kryer një kurs për gjuhën Angleze në "****", Tiranë gjatë viteve 2015 - 2018. Shpenzimet për pagesat e këtij kursi kanë qenë gjithsej 900 euro. (Nuk disponon fatura).

68. Shpenzime për studime personale:

- Kryer studimet në Shkollën e Avokatisë të Shqipërisë, Tiranë, Dhoma e Avokatisë, gjatë periudhës tetor 2019 - korrik 2020. Pagesa ka qenë rreth 112.200 lekë, nga të cilat 102.200 lekë ndjekja e shkollës dhe 10.000 lekë dhënia e testimit.

69. Konkluzion:

- ✓ Në total shpenzimet për arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, personale apo të personave të lidhur anë 638.200 lekë dhe 900 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Mandat arkëtimi, datë 28.10.2020**, ku Altin Merizaj, arkëton vlerën 10 000 lekë për provim dt. 14 nëntor, godina. Liria, Q. Studenti.
- **Depozitim në llogari të Union Bank**, datë 28.10.2020, ku Altin Merizaj, krediton vlerën 102.200 lekë, për Dhoma Kombëtare e Avokatisë, pagesa shkolle viti 2019 - 2020.

70. Në proces verbalin e datës 23.6.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga

trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se për arsimimin e fëmijëve ashtu si e ka deklaruar, nuk ka pasur shpenzime, pasi kanë ndjekur shkolla publike Djali ka ndjekur një kurs privat për gjuhën angleze në "****" gjatë viteve 2016 - 2019 shpenzimet për të cilin i ka deklaruar rreth 900 Euro me përafërsi me sa mban mend pasi nuk ka pasur të ruajtura fatura, por tani që mori vërtetim nga qendra "****" rezulton se shpenzimet për ndjekjen e këtij kursi nga djali, duke përfshirë dhe blerjen e librave e bazës materiale ne total kanë shkuar 1.369 euro.

- Në lidhje me studimet e kryera nga ana e tij në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, niveli Bachelor për katër vjet studime (part time), ka deklaruar se pagesa ka qenë rreth 94.000 lekë për çdo vit, sipas informacionit të marrë me shkresë së fundmi nga fakulteti rezulton se pagesa që ka bërë ka qenë 93.600 lekë për çdo vit, totali 374.400 lekë.
- Në lidhje me studimet e kryera nga ana e tij në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, niveli Master Shkencor për dy vjet, ka deklaruar në total 150.000 lekë për të dyja vitet, sipas informacionit të marrë me shkresë së fundmi, rezulton se ka paguar vetëm një vit akademik, konkretisht vitin 2012 - 2013, në vlerën 62.400 lekë, por shpjegon se ka paguar dhe vitin e dytë Master, por në Fakultet nuk i del në sistem. Ka mbaruar studimet dhe është diplomuar në vitin 2014 dhe është i Sigurt që ka bërë dhe pagesën e vitit të dytë Master, pasi nëse nuk bënte pagesën nuk futej në provimin e diplomimit. Duke parë se sipas vërtetimit për vitin e parë Master ka paguar 62.400 lekë, kaq është vlera që ka paguar dhe për vitin e dytë në Master, pra në total 124.800 lekë për dy vite ndjekje studime Master.

- **Total** studimet në Fakultetin Juridik, Bachelor dhe Master Shkencor **papaguar 499.200 lekë**.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Diplomë nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë**, për Altin Merizaj, datë 20.9.2012.
 - **Diplomë Master i Shkencave, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë**, për Altin Merizaj, datë 17.11.2014.
 - **Shkresë nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë**, datë 14.06.2023, ku informon se Altin Merizaj ka kryer pagesa në programin Bachelor paret - time dhe Master Shkencor Penal, për periudhën 2008 - 2013, në vlerën totale 436.800 lekë.
 - **Dëftesë nga Shkolla Hermann *****, datë 15.07.2022, për nxënësin A. Merizaj, viti shkollor 2021 - 2022.
 - **Dëftesë nga Shkolla 9 vjeçare Ali *****, për nxënësin A. Merizaj, viti shkollor 2020-2021.
 - **Vërtetim pagese nga The Lincoln *****, datë 13.6.2023, ku konfirmon se A. Merizaj, për periudhën tetor 2016 - maj 2019, ka kryer pagesa në vlerën totale 1.369 euro.
- **TOTAL rreth 509.000 lekë + 1.369 euro.**

DEKLARIMI 1 BASHKËSHORTES – L. MERIZAJ

DEKLARIMI 1 PASURIVE

- ✚ Pasuri e pa luajtshme truall me nr. ***, vol. II, fq. **, me sip. 2.340 m², në zonën kadastrale nr. ***, Tiranë, përfituar me trashëgimi nga prindërit, regjistruar në 30.10.2017. Bashkëpronar me pjesë takuese 4.166 % e kësaj sipërfaqe.

Burimi i të ardhurave: pasuri e trashëguar.

- ✚ Pasuri e pa luajtshme truall me nr. ***, vol. * *, fq. **, me sip. 1.235 m², në zonën kadastrale nr. ***, Tiranë, përfituar me trashëgimi nga prindërit, regjistruar në 30.10.2017. Bashkëpronar me pjesë takuese 4.166 % e kësaj sipërfaqe.

Burimi i të ardhurave: pasuri e trashëguar.

- Të dyja këto prona truall, me kontratë sipërmarrje nr. rep. ***, nr. kol. ***, data 2.7.2020 të notere B. K. ndërmjet bashkëpronarëve dhe firmës ndërtuese shoqëria *** shpk, janë dhënë për ndërtim objekti banimi dhe shërbimesh, ku ka dalë leja e ndërtimit dhe ka filluar ndërtimi i objektit. Akoma nuk është nënshkruar me shoqërinë e ndërtimit kontrata për pjesën takuese si bashkëpronar trualli në objektin në ndërtim.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 30.10.2017**, për pasurinë e llojit truall, me nr. ***, vol. **, fq. **, zk ***, me sip. 1.235 m², ndodhur në Tiranë, në emër të L. Merizaj,

e cila zotëron 21/504 pjesë takuese, si dhe 11 bashkëpronarëve të tjerë. Bashkëlidhur kartela e pasurisë dhe harta treguese.

- **Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 30.10.2017**, për pasurinë e llojit truall, me nr. ***, vol. **, fq. **, zk ***, me sip. 2.340 m², ndodhur në Tiranë, në emër të L. Merizaj, e cila zotëron 21/504 pjesë takuese, si dhe 11 bashkëpronarëve të tjerë. Bashkëlidhur kartela e pasurisë dhe harta treguese.
- **Kontratë sipërmarrje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 2.7.2020**, me palë sipërmarrëse shoqëria "****" shpk dhe palë pronarë të truallit ndër të tjerë L. Merizaj, me objekt vënien në dispozicion të pasurive me sip. 2.340 m² dhe 1.235 m², të ndodhura në Tiranë, shoqërisë *** shpk. Pala sipërmarrëse do të ndërtojë në këto pasuri, pallate shumëkatëshe dhe do të kalojë në pronësi të pronarëve sipërfaqen ndërtimore prej 30 0%, dhe jo me pak se 3.600 m² të çdo lloji ndërtimi. Mbi përqindjen e sipërcituar pronarëve të truallit ju takon edhe 400 m² shtesë. Sipërmarrësi merr përsipër lejen brenda 24 muajve nga nënshkrimi i kësaj kontrate. Me mbarimin e këtij afati kontrata do të konsiderohet e zgjidhur.
- **ASHK. Drejtoria Vendore Tirana Veri me shkresën nr. *** prot, datë 26.6.2023**, konfirmon në emër të L. Merizaj, truall me sip. 1.235 m², zk. ***, vol. **, fq. **, dhe truall me sip. 2.340 m², zk. ***, vol. **, fq. **, në bashkëpronësi me 11 persona të tjerë. Bashkëlidhur praktika, si dhe dokumentacioni si më poshtë:
- **Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 21.01.2014**, për pasurinë e llojit truall, me nr. ***, vol. **, fq. **, zk. ***, me sip. 1.235 m², ndodhur në Tiranë, ku ndër b/pronarë të tjerë L. H. zotëron 84/504 pjesë takuese, në bashkëpronësi me familjarët.
- **Certifikatë për vërtetim pronësie, date 21.01.2014**, për pasurinë e llojit truall, me nr. ***, vol. **, fq. **, zk ***, me sip. 2.340 m², ndodhur në Tiranë, ku ndër b/pronarë të tjerë L. H. zotëron 84/504 pjesë takuese, në bashkëpronësi me familjarët.
- **Dëshmi trashëgimie ligjore, nr. *** rep, nr. *** kol, datë 13.9.2017**, me kërkues shtetasen F. H., me objekt "Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin L. H.", me trashëgimtarë F. H., B. H., L. M. (H.) dhe I. H.
- **Kartela e pasurisë, datë 20.6.2023**, për pasurinë e llojit truall, me nr. ***, vol. **, fq. **, zk. ***, me sip. 1.235 m², ndodhur në Tiranë, në emër të L. Merizaj në bashkëpronësi.
- **Kartela e pasurisë, datë 20.06.2023**, për pasurinë e llojit truall, me nr. ***, vol. **, fil. **, zk. ***, me Sip. 2.340 m², ndodhur në Tiranë, në emër të L. Merizaj në bashkëpronësi me 11 persona të tjerë, regjistruar në datë 5.5.2022.
- **Kartela e pasurisë**, për pasurinë e llojit truall, me nr. ***, vol. **, fil. **, zk. ***, me Sip. 1.235 m², ndodhur në Tiranë, në emër të L. Merizaj në bashkëpronësi, regjistruar në datë 28.04.2022.

71. Në proces verbalin e datës 23.06.2023 subjekti sqaroi se fitimi i kësaj pronë nga bashkëshortja është më trashëgimi, pas vdekjes së babait të saj L. H. Subjekti ka dorëzuar dokumentacionin, si më poshtë:

- Vendim nr. ***, datë 14.8.1994, për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, ku është vendosur ti njohë bashkëpronësinë e ish pronarëve R. H., A. H., B. Gj., M. J. dhe nënës

së tyre Q. (për trashëgimtarët e saj), pronësinë mbi 14.300 m² truall. Ti kthejë secilit prej pronarëve nga 3.575 m² truall të lirë.

- Vërtetim nga dokumenti hipotekor, datë 30.6.2004, me pronarë pjesëtarë të familjes H., ndër to edhe shtetasi L. H., i cili zotëron 4/28 pjesë takuese, të pasurisë me nr. ***, zk ***, me sipërfaqje trualli prej 3.575 m², ndodhur në rrugën ***, Tiranë.
- Dëshmi trashëgimie ligjore, nr. *** rep, nr. *** kol, datë 13.9.2017, me kërkues shtetasen F. H., me objekt "Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin L. H. ", me trashëgimtarë F. H., B. H., L. M. (H.) dhe I. H.

Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK. Drejtoria Vendore Tiranë Veri.

72. Konkluzion:

- ✓ Pasuritë e trashëguara: truall me Sip. 2.340 m², dhe me Sip. 1.235 m², të përfituara nga bashkëshortja me trashëgimi ligjore, me pjesë takuese 21/504 pjesë rezultojnë të dhëna me kontratë sipërmarrje në vitin 2020, ku bashkëshortja do të përfitojë pjesë takuese në ndërtimin që do të kryhet në këto pasuri.

- ✚ **Automjet i markës Volkswagen**, modeli Golf 6, me targa ***, viti i prodhimit 2011, ngjyra gri e errët, blerë në datë 23.09.2019 me çmimin 4.500 euro.

Burimi i krijimit: nga kursimet e mia nga paga, por dhe kursimet familjare, ku përfshihen dhe të bashkëshortit. Zotëron 100 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Certifikata e pronësisë së mjetit rrugor**, me targë *** datë 24.9.2019, në emër të L. Merizaj, tipi VW Golf, Viti 2011. Bashkëlidhur leja e qarkullimit.
- **Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol**, datë 23.9.2019, me palë shitëse I. Sh. dhe blerës L. Merizaj, për automjet tip Volkswagen, në vlerën 4.500 euro.
- **DPSHTRR me shkresën nr. *** prot, datë 12.5.2023**, konfirmon në emër të L. Merizaj, mjetin me targë *** tip Volkswagen, blerë sipas kontratës së datës 23.09.2019, në vlerën 4.500 euro.

Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.

73. Konkluzion:

- ✓ Automjeti Volkswagen, Golf 6, rezulton të jetë blerë nga bashkëshortja e subjektit, në vitin 2019, me burim kursimet familjare.

- ✚ **Llogari bankare page tek Tirana Bank**, me balancë në datë 07.03.2023 në vlerën 44.604 lekë. Vlera e overdraft: 270.000 lekë. Shuma prej 44.604 lekë. Zotëron 100 %.

Burimi i të ardhurave: kursime nga paga, të lëna në llogari pa u tërhequr.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank**, datë 7.3.2023, për llogari në lekë, në emër të L. Merizaj, për periudhën 06.01.2011 - 06.03.2023, me balancë në vlerën 44.604 lekë.
- Tirana Bank me shkresën nr. 23/5 prot, datë 02.05.2023, konfirmon në emër të L. Merizaj, llogari page në lekë, me gjendje në datë 10.03.2023, në vlerën 44.604 lekë. Konstatohet; Gjendja e llogarisë bankare është krijuar gjatë periudhës 2011 - 2023 me të ardhurat nga paga.

🚧 **Apartament banimi me sip. 90.7 m²**, me adresë rruga "****", pallati nr. ****, shk. *, k. *, ap. **, Tiranë. Blerë më datë 30.12.2011. *(trajtuar më lart)*

🚧 Automjet i markës Ford, modeli Focus, me targa ***, viti i prodhimit 2000, blerë në 30.8.2012, çmimi 2.000 euro. Kjo makinë në datë 21.2.2017 është shitur sipas kontratës noteriale me çmim 1.500 euro.

Burimi i krijimit: nga kursimet familjare.

74. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol**, datë 30.8.2012, me palë shitëse B. H. dhe blerës L. Merizaj, për automjet tip Ford Focus, viti 2001, në vlerën 2.000 euro.
- **Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 21.2.2017**, me palë shitëse L. Merizaj dhe blerës L. A., për automjet tip Ford Focus, me targë **, në vlerën 1.500 euro.
- **Vërtetim nga DPSHTRR, datë 03.03.2023**, ku vërteton se L. Merizaj ka patur në pronësi mjetin me targë ***. Aktualisht ka në pronësi mjetin me targë ***.
- **DPSHTRR me shkresën nr. *** prot, datë 12.5.2023**, konfirmon në emër të L. Merizaj, mjetin me targë ***, tip Ford Focus, viti 2001, blerë sipas kontratës së datës 30.8.2012, në vlerën 2.000 euro dhe shitur sipas kontratës së datës 21.2.2017, në vlerën 1.500 euro.

75. Konkluzion:

- ✓ Automjeti me targë ***, rezulton të jetë blerë në vitin 2012 dhe shitur në vitin 2017.

DEKLARIMI 1 TË ARDHURAVE

🚧 Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit nga data e emërimit 01.09.2003 deri në datë 07.03.2023 janë:

76. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

Sipas të dhënave nga **Raiffeisen Bank**, për periudhën **01.05.2005 - 31.12.2010** të ardhurat nga paga janë 4.522.758 lekë.

(Në janar 2011 rroga është transferuar te Tirana Bank) Sipas të dhënave të nxjerra nga Tirana Bank, për periudhën **01.01.2011 - 07.03.2023**, të ardhurat nga paga si punonjës policie janë 14.354.308 lekë.

- Në total të ardhurat nga paga si punonjës policie, për periudhën **01.09.2003 - 07.03.2023** janë 19.564.708 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës**, ku vërteton se L. Merizaj ka përfutur të ardhura neto për periudhën 16.7.2004 - 30.4.2005, në vlerën totale 326.756 lekë.
- **Tirana Bank, datë 7.3.2023**, për llogari në lekë, në emër të L. Merizaj, për periudhën 6.1.2011 - 6.3.2023. Për periudhën janar - dhjetor 2012, kreditimet nga paga janë në vlerën totale 1.215.541 lekë dhe për periudhën janar - dhjetor 2015 kreditimet nga paga janë në vlerën totale 1.093.550 lekë. Raiffeisen Bank. me shkresën nr. 23/2 prot, datë 8.5.2023, ka bashkëlidhur CD të llogarive të L. Merizaj, ku konfirmohen kreditimet nga paga dhe shpërblime për periudhën 17.05.2005 - 30.12.2010, në vlerën totale rreth 3.438.000 lekë.
- **Tirana Bank** me shkresën nr. *** prot, datë 02.05.2023, konfirmon në emër të L. Merizaj, llogari page në lekë, ku konfirmohen kreditimet nga paga dhe shpërblime për periudhën 06.01.2011 - 02.03.2023, në vlerën totale rreth 11.794.517 lekë. Në këtë vlerë nuk përfshihen vitet 2012 dhe 2015, në statement bankar bashkëlidhur shkresës. ISSI-I me shkresën nr. *** prot, datë 10.05.2023, konfirmon pagat neto të L. Merizaj, për periudhën dhjetor 2012 - mars 2023.
- Në **proces-verbalin e datës 23.06.2023**, subjekti sqaroi të ardhurat nga paga të bashkëshortes për periudhën 01.01.2011 07.03.2023, dhe 01.5.2005 - 31.12.2010. Bashkëlidhur deklaratës ka dërguar dokumentin e marrë nga banka, që është përdorur për mbledhjen e të ardhurave.
- Të ardhurat neto të bashkëshortes së subjektit. nga paga dhe shpërblimet për periudhën shtator 2003 - mars 2023 rezultojnë në vlerën totale rreth 18.229.000 lekë.

DETYRIME FINANCIARE

Nuk ka asnjë detyrim financiar të marrë dhe të pa shlyer në momentin e deklarimit.

Detyrime financiare, kredi të marra dhe të shlyera gjatë periudhës si punonjës i Policisë së Shtetit nga 01.09.2003 deri 07.03.2023 janë si më poshtë:

- **Kredi bankare në Raiffeisen Bank**, marrë më datë 06.04.2007 në shumën 300.000 lekë, e cila është shlyer para afatit, konkretisht në datë 09.01.2009. Kjo kredi është marrë për blerjen e disa pajisjeve të punës së babait të bashkëshortit B. Merizaj, i cili në këtë

periudhë ishte i vetëpunësuar në punishte private për prodhimin e dyerve e dritareve të aluminit. Nuk kam mundur të siguroj dokumente për këtë kredi dhe nuk mbaj mend sa ka qenë nr. kontratës, interesi dhe kësti mujor.

- **Kredi bankare në Raiffeisen Bank**, marrë më datë 09.01.2009, në shumën 600.000 lekë, e cila është shlyer deri në 30.08.2012. Kjo kredi është marrë për shlyerjen e kredisë së mëparshme (*përshkruar më sipër*) dhe një pjesë për kryerjen e disa punimeve rikonstruksioni në banesën ku jetonim në këtë periudhë në adresën, rruga "****". Nuk kam mundur të siguroj dokumente për këtë kredi.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Vërtetim nga Raiffeisen Bank, datë 19.04.2018**, ku konfirmohet kredi e disbursuar më datë 06.04.2007 nga L. Merizaj, në vlerën 300.000 lekë, e cila rezulton e shlyer në vitin 2009.
- **Vërtetim nga Raiffeisen Bank, datë 19.04.2018**, ku konfirmohet kredi e disbursuar më datë 09.01.2009 nga L. Merizaj, në vlerën 600.000 lekë, e cila rezulton e shlyer në vitin 2012.

77. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

Raiffeisen Bank. me shkresën nr. ** prot, datë 8.5.2023**, ka bashkëlidhur CD të llogarive të L. Merizaj, ku konfirmohet kredi e disbursuar më datë 06.04.2007, në vlerën 300.000 lekë, e mbyllur në vitin 2009, si dhe kredi e disbursuar në datë 09.01.2009 në vlerën 600.000 lekë, mbyllur në vitin 2012. Konstatohet se në datën 09.01.2009 tërheq nga llogaria vlerën 452.000 lekë, ndërsa vlerën prej 144.872 lekë e transferon për mbyllje kredie të mëparshme në vlerën 300.000 lekë, në vitin 2007.

78. Në proces verbalin e datës 23.6.2023, subjekti sqaroi se për shpenzimet e kryera për rikonstruksionin e banesës, nuk disponon dokumentacion të blerjes së materialeve apo kryerjes së punimeve. Shpjegon se shumica e këtyre punimeve si kangjellat, instalime hidraulike, pllaka tualeti janë bërë nga vet babai i tij B. Merizaj. Lidhur me kredinë e marrë nga bashkëshortja në vitin 2009, në Raiffeisen Bank, shpjegon se nga vlera 600.000 lekë janë tërhequr 450.000 lekë, ndërsa 150.000 lekë janë përdorur për të mbyllur një kredi të mëparshme të marrë po nga bashkëshortja në Raiffeisen Bank, në vlerën fillestare 300.000 lekë. Shuma prej 450.000 lekë e marrë kredi është përdorur për rikonstruksion e apartamentit ku banonin. Shpjegon këtu se kredia e mëparshme e marrë nga bashkëshortja në vlerën 300.000 lekë, në vitin 2007, është marrë për blerjen e disa pajisjeve të punës së babait B. Merizaj, i cili në këtë periudhë ishte i vetëpunësuar në punishte private për prodhimin e dyerve e dritareve të aluminit, për të cilin nuk disponon dokumentacion, pasi ka qenë i pasiguruar pranë organeve tatimore.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Deklaratë e thjeshtë nga shtetasi B. Merizaj**, datë 17.06.2023, i cili deklaron se në viti 2004 kanë ardhur familjarisht në Tiranë, ku kanë blerë një apartament në rrugën "****", e cila ka patur një shtesë të ndërtuar, në të cilën ka punuar për bërjen e dritareve

dhe dyerve të aluminit, deri në vitin 2011, kur e kanë shitur këtë shtëpi. Shpjegon se gjatë këtyre viteve nuk ka qenë i regjistruar në institucionet tatimore, pasi ka qenë punishte e vogël. Për të vërtetuar faktin që ka punuar gjatë këtyre viteve nuk disponon dokumentacion zyrtar, por mund të sigurojë deklarata nga persona të ndryshëm, që u ka bërë dritare dhe dyer alumini për banesat e tyre.

- **Deklaratë e thjeshtë dore nga shtetasi P. K.**, i cili deklaron se me shtetasin B. Merizaj, që punonte me duralumin rreth vitit 2005 ka kryer punime në hyrjen e tij dhe e ka paguar për punën e kryer.
- **Deklaratë e thjeshtë dore nga shtetasi B. H.**, i cili deklaron se B. Merizaj ka punuar me te për një kohë të gjatë me duralumin, nga Viti 2004 deri në vitin 2011.
- **Deklaratë e thjeshtë dore nga shtetasi D. Xh.**, i cili deklaron se nga shtetasi B. Merizaj ka bërë punime duralumini në vlerën 330.000 lekë.
- **Drejtoritë dhe Zyrat Vendore të ASHK-së**, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në proces legalizimi në emër të subjektit dhe personave të lidhur.
- **Raiffeisen Bank** me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, konfirmon në emër të Altin Merizaj, llogari master card në vlerën 0 euro.
- **Abi Bank me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023**, konfirmon se A. Merizaj, ka patur llogari shpërblimi si bebe e porsalindur, ku është kredituar vlera 5.000 lekë në vitin 2011.
- **Credins Bank, me shkresën nr. *** prot, datë 30.05.2023**, konfirmon llogari të mbyllur në emër të A. Merizaj, ku konstatohet një kreditim në datën 25.11.2016, në vlerën 27.000 lekë, me përshkrimin "Dhënie stimuli për rezultate"
- **QKB, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023**, konfirmon se shtetasja F. H., është e regjistruar si person fizik, me Nipt. ***, në datë 05.03.2001, me objekt tregti me pakicë, lule artificiale, me adresë në Tiranë, me status aktiv.
- **DPT me shkresën nr. *** prot, datë 12.05.2023**, konfirmon se subjekti apo personat e lidhur nuk figurojnë të regjistruar pranë organeve tatimore, për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat.
- **ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën me nr. V-Prot, datë 16.05.2023**, përcjell shkresën e Degës së Arkivit të Rajonit Tiranë, e cila informon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave, për periudhën 1994 -2012 të punonjësve të siguruar në subjektet shtetërore, juridike apo fizikë, nuk mund të konfirmohet periudhë kontributesh apo paga, mbi të cilën janë siguruar, në qoftë se nuk jepet emërtimi i qendrës së punës, Nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës.
- **Vërtetim nr. *** prot, datë 15.05.2023**, nga Drejtoria e Arkivit Qendror, për subjektin dhe personat e lidhur.
- **Drejtoria e Përgjithshme Detare, me shkresën nr. *** prot, datë 10.05.2023**, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të subjektit apo personave të lidhur.

79. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave, u bë analiza e të

dhënave të deklaruara nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, proces nga i cili, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se;

- **Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar**, pasuria totale deri në datë 10.03.2023, është deklaruar është bruto/neto 9.408.305 lekë + 4.500 Euro e konvertuar rreth 9.922.000 lekë.
- **Të ardhurat neto** të subjektit nga paga, shpërblime dhe dieta, për periudhën shtator 2003 - mars 2023, rezultojnë në vlerën totale rreth 16.969.000 lekë.
- **Të ardhurat neto** të bashkëshortes së subjektit, nga paga dhe shpërblime për periudhën shtator 2003 - mars 2023, rezultojnë në vlerën totale rreth 18.229.000 lekë.
- **Të ardhura** të përfituara gjatë periudhës 2014 - 2020, nga shit-blerja e automjeteve (diferenca mes çmimit të blerjes dhe shitjes), rezultojnë në vlerën totale të konvertuar, në rreth 1.816.000 lekë, për të cilën janë paguar edhe detyrimet përkatëse tatimore.

C. KONTROLLI I FIGURËS

80. Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

🚦 Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:


1. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
2. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, germa (ë), e ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

🚦 Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit **z. Altin Merizaj** me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

🚦 **Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”;
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;

c. Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligj zbatuese në Republikën e Shqipërisë.

 Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore si organ ndihmës, në përputhje me nenin 42 të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, për vlerësimin e kontrollit të figurës ka dorëzuar nëpërmjet shkresës Nr. *** datë 18.07.2023 raportin e kontrollit të figurës² ku ka konstatuar se:

× **Subjekti i vlerësimit z. Altin Merizaj, me detyrë Drejtor në “Drejtorinë Vendore Për Kufirin dhe Migracionin, Durrës”, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.**

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:

- Nuk është njohur nga të tjerët me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që ka patur apo ka regjistruar në gjendjen civile.
- Nuk ka pasur apo ka shtetësi tjetër.
- Nuk ka qenë asnjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdher kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë ndaj tij masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar
- Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

² Raport për kontrollin e figurës

- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit
- Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish – shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë.

Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, Trupa e vlerësimit konstatoi se:

Në mbështetje të neneve 35-42, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar trupa e vlerësimit zhvilloj hetimin mbi kontrollin e figurës duke u bazuar në kthim-përgjigjet e institucioneve ligj zbatuese në Republikën e Shqipërisë, raportin e Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit dhe deklaratimet e subjektit të vlerësimit **nga ku u konstatua:**

81. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën “E paklasifikuar”, nr. **** prot., datë 09.06.2023, për subjektin e vlerësimit z. Altin Merizaj bën me dije se:

- a. Nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve
- b. Nuk ka ndryshuar shtetësi (lenie ose marrje shtetësie)

82. Drejtoria e Përgjithshëm e Burgjeve me shkresën “i kufizuar”, nr. **** prot., datë 19.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Altin Merizaj bën me dije se:

- a. Nuk rezulton i dënuar

83. Institucion Ligjzbatues me shkresën “Sekret”, nr. **** prot., datë 25.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Altin Merizaj bën me dije se:

- a. Nuk disponon të dhëna.

84. Institucion Ligjzbatues me shkresën “I kufizuar”, nr. ****prot., datë 30.05.2023, dhe shkresë “e paklasifikuar”, nr. **** datë 31.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Altin Merizaj si dhe për personat e lidhur sipas certifikatës familjare nuk kanë:

- a. Të dhëna apo indice për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimin e ngritur në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;

- b. Të dhëna për kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar (*sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.95/2016, “për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*) ku mund të përfshihen biseda, foto, vëzhgime takimesh apo biseda telefonike etj.;
- c. Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (*të dënuar ose proceduar penalisht, brenda apo jashtë territorit të republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, “për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë i ndryshuar.*);
- d. Të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e ndonjë vepre penale;
- e. Të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e ndonjë vepre penale.
- f. Të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhër-arresti ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
- g. Të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
- h. Të dhëna për gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO.
- i. Të dhëna që nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- j. Nuk ka procedime disiplinore apo masa disiplinore.

85. Institucion Ligjzbatues, me shkresën “Konfidencial”, nr. **** prot., datë 31.05.2023., për subjektin e vlerësimit z. Altin Merizaj bën me dije se:

- a. Nuk disponon të dhëna.

86. Institucion Ligjzbatues, me shkresë “sekret”, e datës 13.06.2023, shkresën “sekret”, nr. **** prot., datë 19.06.2023, dhe shkresën “sekret”, nr. ****. prot, datë 26.06.2023, për subjektin e vlerësimit z. Altin Merizaj dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare bën me dije se:

- a. Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të paligjshëm;
- b. Nuk ka procedime penale të referuara;
- c. Për subjektin e vlerësimit nuk administrohen ankesa, të dhëna ose informacione;

87. Institucion Ligjzbatues, me shkresën “i kufizuar”, nr. ****. prot, datë 10.07.2023 për subjektin e vlerësimit z. Altin Merizaj bën me dije se:

- a. Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi;
- b. Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal;
- c. Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo presonit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
- d. Nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprës penale;
- e. Nuk ka pasur raste të urdhrit ndërkombëtar të ndalimit;

88. Institucion Ligjzbatues, me shkresën “i kufizuar”, nr. **** prot., 01.06.2023, bën me dije se, për subjektin e vlerësimit z. Altin Merizaj:

- Nuk rezulton të jetë regjistruar procedimi penal.

89. Institucion Ligjzbatues, me shkresën “sekret”, nr. **** prot., datë 25.05.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit Altin Merizaj dhe personat e lidhur me të:

- Nuk rezultuan raportime.

90. Autoriteti Kombëtar për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar, me shkresën “i kufizuar”, nr. **** prot., datë 25.05.2023 për subjektin e vlerësimit z. Altin Merizaj bën me dije se:

- Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), niveli i klasifikimit “Tepër Sekret” lëshuar me datë 04.02.2021, të vlefshme deri në datën 04.02.2026.
- Për subjektin e vlerësimit nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së.
- Nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

91. Avokati i Popullit me shkresën “e paklasifikuar”, me nr. **** prot., datë 30.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Altin Merizaj bën me dije se:

- Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

92. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën “i kufizuar”, nr. *** prot., datë 08.06.2023, për subjektin e vlerësimit z. Altin Merizaj, bën me dije se:

- Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 Korrik 1991.

93. Denoncime nga publiku:

Për subjektin e vlerësimit z. Altin Merizaj është disponuar një ankesë nëpërmjet portalit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore për denoncime nga publiku për subjektet e vlerësimit kalimtar dhe periodik, ku sinjalizohet se subjekti dispononte një banesë të pa deklaruar, në njësinë administrative Petrelë.

- Në lidhje me këtë sinjalizim nga ana e Trupës së Vlerësimit u bënë verifikimet përkatëse: **Drejtoritë dhe Zyrat Vendore të ASHK-së, FSHU dhe UKT, Tiranë**, nuk konfirmuan pagesa, regjistrime apo pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në proces legalizimi, në emër të subjektit apo personave të lidhur me të.

- ✘ **Trupa e Vlerësimit nuk arriti të provojë vërtetësinë e faktit, ardhur nëpërmjet portalit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në kuadër të denoncimeve të bëra nga publiku.**

94. Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, me nr. ***, datë 11.01.2024, “Akt Ekzaminimi Toksikologjiko-Ligjor” konkludohet se subjekti vlerësimit **z. Altin Merizaj**:

✓ **Nuk janë zbuluar prania e substancave narkotike.**

🚩 Në përfundim të hetimit të kryer:

95. Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Altin Merizaj, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, analizimit dhe verifikimit të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligj zbatuese, vlerësimit të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit z. Altin Merizaj :

- *Ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;*
- *Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONAL

🚩 Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

96. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;

- raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit/Gardën e Republikës/Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

Subjekti i vlerësimit **z. Altin Merizaj** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin **Drejtor në “Drejtorinë Vendore Për Kufirin dhe Migracionin, Shkodër”**. Në momentin e hedhjes së shortit dhe përzgjedhjes së trupës së vlerësimit datë 05.04.2023 subjekti i vlerësimit mbante po funksionin e Drejtor në “Drejtorinë Vendore Për Kufirin dhe Migracionin, Shkodër” dhe aktualisht funksionin Drejtor i “Drejtorisë Vendore Për Kufirin dhe Migracionin, Durrës”.

- ✚ Periudha e vlerësimit në zbatim të nenit 44 pika 2 të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar është periudha 5-vjeçare (2018-2022). Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale do të shkrihet brenda këtij harku kohor.

C/1 RAPORTI I VLERËSIMIT PROFESIONAL POLICIA E SHTETIT.

97. Struktura e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr.12/2018 i ndryshuar ka dorëzuar nëpërmjet shkresës nr. *** datë 30.06.2023 raportin e vlerësimit profesional është shprehur me konkluzion përfundimtar si më poshtë vijon:

- ✚ **Punonjësi i Policisë z. Altin Merizaj është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka përmbushur detyrat profesionale, respektuar rregullat e etikës, si dhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.**

C/2 HETIMI I TRUPËS SË VLERËSIMIT PRANË AGJENCISË SE MBIKËQYRJES POLICORE:

98. Trupa e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me ligjin e vlerësimit si dhe ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, ka zhvilluar një hetim administrativ të plotë dhe të bazuar në fakte dhe prova duke u bazuar në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit nr. *** ;
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Sistemi RMIS me nr. ***;
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1 të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar.
- Të dhënat e siguruar nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi performancën e subjektit.

99. Punonjësi i Policisë, Drejtues, Altin Merizaj është emëruar në detyrë Drejtor i Drejtorisë Vendore Për Kufirin dhe Migracionin, Shkodër me urdhrin nr.*** datë 03.11.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

- Në zbatim të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, funksioni që mban z. Altin Merizaj bën atë subjekt të ligjit sipas nenit 6.

100. Vlerësimi i nivelit të arsimit.

Niveli i arsimit	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundimi	Vendi	Titulli/Diploma
Arsim i Lartë	Akademia e Policisë	2000	2003	Tiranë	Diplomë
DPN	Fakulteti i Drejtësisë	2009	2012	Tiranë	Diplomë
Master Shkencor	Fakulteti i Drejtësisë Penale	2012	2014	Tiranë	Diplome

- Trupa e vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore administroj nga dosja e subjektit të vlerësimit diplomat.
- Në kuptim të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që mban pranë Policisë së Shtetit, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.

101. Konkluzion:

- ✓ Trupa e Vlerësimit në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, konstaton se subjekti i vlerësimit gëzon nivelin e nevojshëm të arsimit për pozicionin e punës që mban.
- ✓ Në kuptim të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që mban pranë Policisë së Shtetit.

🚦 Hetimi i zhvilluar nga Trupa e Vlerësimit mbi trajnimet dhe kualifikimet e subjektit të vlerësimit në përputhje me nenin 43-45, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

102. Certifikatat e trajnimeve, kualifikimet dhe medaljet:

Trupa e vlerësimit pas administrimit të dosjes së personelit, raportit të vlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, konstatoj se gjatë periudhës 5 vjeçare të vlerësimit në zbatim të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar, subjekti i vlerësimit:

- ✘ nuk ka realizuar trajnime,
- ✘ nuk ka marrë certifikatë për performancë të lartë në realizimin e detyrave.

Trupa e vlerësimit vë në dukje faktin se, dokumentacioni bashkëlidhur raportit të vlerësimit, përmban certifikata trajnimesh për subjektin e vlerësimit të një periudhë relativisht të hershme për harkun kohor të viteve 2001-2003. Në përputhje me dispozitat e ligjit të vlerësimit kjo periudhë nuk është objekt vlerësimi dhe për këtë arsye këto kualifikime nuk do të trajtohen në kuadrin e kualifikimeve të përfituara nga subjekti i vlerësimit për periudhën (2018-2023).

103. Vlerësimet e punës:

Gjatë zhvillimit të hetimit mbi procesin e vlerësimit të aftësive profesionale trupa e vlerësimit ka konstatuar se:

- Për periudhën e vlerësimit (2018-2022) në dosjen e subjekti të vlerësimit dhe në raportin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, subjekti ka katër vlerësime pune, atë vitit me rezultat “shumë mirë”
- ✘ **Trupa e vlerësimit konstaton se për vitin 2018,** eprorët e subjektit nuk kanë plotësuar vlerësime pune, sipas raportimeve të vetë institucionit.

104. Masat disiplinore:

Trupa e vlerësimit në zhvillim të hetimit ka kryer verifikime në dosjen personale të subjektit të vlerësimit si dhe në sistemin RMIS, nga ku rezulton se gjatë periudhës 5-vjeçare, (2018-2022) të përcaktuar në pikën 2 të nenit 44 të ligjit 2018 i ndryshuar, subjekti i vlerësimit nuk ka marrë asnjë masë disiplinore.

- ✓ **Trupa e Vlerësimit konstaton se** subjekti përgjatë periudhës së vlerësimit nuk ka asnjë masë disiplinore në ngarkim.

105. Ecuria në karrierë:

Nga verifikimi i të dhënave të deklaramit të subjektit të vlerësimit, raportit të vlerësimit profesional nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, subjekti i vlerësimit z. Altin Merizaj ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej **19 vitesh e 8 muaj**. Nga verifikimi në dosje personale rezulton se gjatë periudhës 5-vjeçare objekt deklarimi, subjekti mban:

Emërtimi i gradës	Arsyeja e ndryshimit	Nr. urdhri	Data	
			Nga	Deri
Kryekomisar	Ngritur në gradë	Nr.***, datë 27.02.2013	21.04.2014	31.07.2022
Drejtues	Ngritur në gradë	Nr.***, datë 28.07.2022	01.08.2022	vazhdim

Data e fillimit	Data e përfundimit	Institucioni	Funksioni
17.05.2024	vazhdim	DVKM Durrës	Drejtor në “Drejtorinë Vendore Për Kufirin dhe Migracionin, Durrës
17.12.2022	17.05.2024	DVKM Shkodër	Drejtor në “Drejtorinë Vendore Për Kufirin dhe Migracionin, Shkodër”
31.12.2020	16.12.2022	Drejtoria Vendore Policisë Tiranë	Zv. Drejtor për Hetimin e Krimeve të Organizuar
05.06.2018	30.12.2020	Drejtoria Vendore Policisë Tiranë	Shef në Sektorin për Hetimin e Trafikeve dhe Narkotikeve
10.05.2017	04.06.2018	DVKM Durrës	Shef në Sektorin e Kufirit

Policia e Shtetit konkludon se:

- Nga të dhënat e faktit konstatohet se subjekti i vlerësimit gjatë periudhës së vlerësimit ka mbajtur funksionin “**Drejtor**”, në përputhje me kriteret ligjore dhe gradën që disponon. Funksionet dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve në nënligjore.

106. Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese dhe Konkluzionet:

- ✓ Nga të dhënat e faktit konstatohet se subjekti i vlerësimit gjatë periudhës së vlerësimit ka mbajtur funksionin “Drejtor”, në përputhje me kriteret ligjore dhe gradën që disponon.
- ✓ Trupa e vlerësimit në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të subjektit të vlerësimit z. Altin Merizaj, arrin në konkluzionin se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe grada që ai ka përfituar, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

107. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshope, seminare botime brenda dhe jashtë vendit.

- ✓ Trupa e Vlerësimit vë në dukje faktin se dokumentacioni bashkëlidhur raportit të vlerësimit përmban certifikata të pjesëmarrjes në seminare/konferenca/workshope.

Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar për vlerësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin:

Subjekti i vlerësimit z. Altin Merizaj:

- ✓ **Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;**
- ✓ **Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;**
- ✓ **Ka vlerësime pozitive pune.**

KONKLUZION PËRFUNDIMTARE

Trupa Vlerësuese e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit z. Altin Merizaj në përputhje me nenin 60 të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale;

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbledh në dhomë këshillimi referuar nenit 59, germa “ç”, të si dhe nenit 62 germa “ç”, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

V E N D O S I

1. Konfirmimin në detyrë e subjektit të vlerësimit, **z. Altin Merizaj**.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, sot datë **14.06.2024**.

KRYESUES

EDONA DUSHAJ

RELATOR

ENTON RADOVANI

ANËTAR

KLEADA MERSINLLARI